



Bruksel, 18.12.2015  
SWD(2015) 706 final

**DOKUMENT PUNE I STAFIT TË KOMISIONIT**  
*Në përcjellje të dokumentit*

**RAPORTI NGA KOMISIONI PËR PARLAMENTIN DHE KËSHILLIN EVROPIAN**

**Raporti i tretë i progresit të Kosovës\* mbi plotësimin e kërkesave të  
udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave**

{COM(2015) 906 final}

## 1. HYRJE

Komisioni Evropian ka filluar dialogun për liberalizimin e vizave me Kosovën\* më 19 janar 2012. Më 14 qershor 2012, i ka dorëzuar qeverisë së Kosovës udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave. Ky dokument ka identifikuar të gjithë legjislacionin dhe masat tjera që Kosova duhet të miratoj dhe zbattoj për të avancuar drejt liberalizimit të vizave.

Komisioni ka miratuar dy raporte mbi progresin e Kosovës në dialogun e vizave: raportin e parë me 8 shkurt 2013;<sup>1</sup> të dytin me 24 korrik 2014.<sup>2</sup> Këto raporte përmbajnë një vlerësim të progresit të bërë nga Kosova, rekomandimet për autoritetet e Kosovës dhe të dhënat statistikore për ndikimet e pritshme migruese dhe të sigurisë nga regjimi pa viza.

Ky është Dokument Pune i Stafit të Komisionit që shoqëron raportin e tretë të Komisionit,<sup>3</sup> që përcakton në më hollësi vlerësimin e Komisionit mbi progresin e Kosovës në plotësimin e kërkesave të udhërrëfyesit të vizave, si dhe ndikimet e pritshme migrues dhe të sigurisë nga liberalizimi i vizave.

Ky DPSK bazohet mbi raportet e dorëzuara nga qeveria e Kosovës, raportet e hartuara nga ekspertët e Shteteve Anëtare të BE-së që kanë marrë pjesë në misionin vlerësues në korrik të vitit 2015, informacionin e marrë nga Zyra e BE-së në Kosovë, EULEX-i dhe agjencitë e BE, si dhe të dhënat statistikore të përpiluara nga Eurostat dhe të paraqitura nga Shtetet Anëtare.

Dialogu i vizave zhvillohet pa paragjykuar pozicionin e vendeve anëtare të BE-së ndaj statusit.

## 2. VLERËSIMI I HOLLËSISHËM I PROGRESIT TË KOSOVËS NË PLOTËSIMIN E KËRKESAVE TË UDHËRRËFYESIT PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE

### KËRKESAT E NDËRLIDHURA ME RIPRANIMIN DHE RIINTEGRIMIN

#### Ripranimi

Kosova ka plotësuar të gjitha shtate kërkesat për ripranim.

#### 1) Të vazhdohet me zbatimin e legjislacionit vendor për ripranim: PLOTËSUAR

Korniza ligjore e Kosovës për ripranim është funksionale. Ajo ka zbatuar dhe vazhdon të zbatojë ligjin e saj për ripranim.

#### 2) Të vazhdohet me zbatimin e marrëveshjeve ekzistuese të ripranimit dhe, kur është e përshtatshme, të lidhën marrëveshje të reja për ripranim: PLOTËSUAR

Kosova ka nënshkruar marrëveshje ripranimi me 17 Shtetet Anëtare të BE-së, me 3 shtete Anëtare të Zonës Shengen dhe me 2 shtete të Ballkanit Perëndimor.<sup>4</sup> Ajo nënshkroi një marrëveshje ripranimi me Turqinë më 15 dhjetor 2015 dhe ka filluar negociatat me shtetet tjera.

#### 3) Të sigurojë procedura të shpejta dhe efektive për identifikimin dhe kthimin e qytetarëve të Kosovës, shtetasve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi të cilët

\* Ky denominim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin, dhe është në pajtim me Rezolutën 1244/99 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe Opinionin e GJND-së për deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

<sup>1</sup> COM (2013) 66

<sup>2</sup> COM (2014) 488

<sup>3</sup> COM (2015) 906

<sup>4</sup> Shqipëria, Austria, Bullgaria, Kroacia, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Hungaria, Italia, Lihtenshtajni, Malta, Mali i Zi, Norvegjia, Sllovenia, Suedia, Zvicra plus një marrëveshje e vetme që mbulon Belgjikën, Luksemburgun dhe Holandën.

**nuk i plotësojnë, ose nuk i plotësojnë më kushtet për hyrje, prezencë, ose qëndrim në territoret e një nga shteteve anëtare dhe të lehtësoj kalimin/transitin e personave në frymë të bashkëpunimit: PLOTËSUAR**

Ripranimi i qytetarëve të Kosovës funksionon mirë, duke përfshirë edhe personat e margjinalizuar.<sup>5</sup> Kosova ka përmirësuar përpunimin e kërkesave; rastet e pazgjidhura nuk përbejnë më një shqetësim. Nuk ka të dhëna për ripranimin e shtetasve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi.

**4) Të sigurojë që procedurat e ripranimit, të kryera përmes kanaleve përkatëse, funksionojnë në lidhje me të gjitha Shtetet Anëtare: PLOTËSUAR**

Ripranimi funksionon në lidhje me të gjitha Shteteve Anëtare dhe Shtetet Anëtare të Zonës Shengen që shprehin dëshirë për t'i kthyer qytetarët e Kosovës në Kosovë.

**5) Të fuqizojë kapacitetet e autoriteteve kompetente për procedimin e aplikacioneve për ripranim dhe të ulët numri i kërkesave të pazgjidhura për ripranim: PLOTËSUAR**

Autoritetet e Kosovës përgjegjëse për ripranim kanë kapacitetin e duhur për të pranuar kthimet nga Shtetet Anëtare të BE-së dhe Shtetet Anëtare të Zonës Shengen. Kërkesat në pritje nuk përbejnë më një shqetësim.

**6) Të sigurojë që aplikacionet për ripranim të procedohen në pajtim me rregullat vendore për mbrojtje të të dhënave: PLOTËSUAR**

Bashkëpunimi ndërmjet autoritetit përgjegjës për ripranim dhe agjencisë për mbrojtjen e të dhënave mbetet i kënaqshëm.

**7) Të hartojë dhe komunikojë me kohë statistika të hollësishme për ripranim tek autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare, Komisionit Evropian dhe EULEX-it: PLOTËSUAR**

Ndarja e informacionit dhe shkëmbimi i statistikave në mes të Kosovës, Komisionit Evropian dhe EULEX-it mbetet i menjëhershëm dhe i kënaqshëm.

## **Riintegrimi**

Kosova ka plotësuar **dy nga tre kërkesat** në riintegrim.

**8) Të miratojë dhe zbatojë masat për përcaktimin e roleve dhe përgjegjësive të autoriteteve kompetente për riintegrim, procedurat për aplikim dhe vendimmarrje dhe të drejtat dhe obligimet e përfituesve në kuadër të programit të riintegrit: PLOTËSUAR**

---

<sup>5</sup> Gjatë krizës së jashtëzakonshme të migrimin, nga Kosova gjate periudhës shtator 2014 - prill 2015, 87,495 shtetas të Kosovës kanë kërkuar azil në Shtetet Anëtare të BE-së dhe Shtetet Anëtare të Zonës Shengen. Në dhjetë muajt e parë të vitit 2015, Kosova ka ri-pranuar 9,182 qytetarë të saj.

Rregullorja e Kosovës për riintegrim është zbatuar plotësisht, dhe organi që merret me riintegrim ka burimet e nevojshme për të kryer detyrat e tij.

**9) Të zbatojë strategjinë dhe planin e veprimit për riintegrim, me theks të veçantë mbi raportimin dhe monitorimin; disbursimin dhe decentralizimin e Fondit të Riintegrit; dhe shtimin e qasjes së të kthyerve, posaçërisht atyre nga minoritetet Rom, Ashkali dhe Egjiptas në punësim, trajnime profesionale dhe edukim: PLESËRISHT E PLOTËSUAR**

Kosova vazhdon të zbatojë strategjinë e saj të përditësuar mbi riintegrimin.

Nga Buxheti i Kosovës janë alokuar 3.2 milion euro për Fondin e Riintegrit në vitin 2015, duke përfshirë 1 milion euro për ndërtimet e akomodimit për të kthyerit. 20% e kësaj shume u shpenzua në gjysmën e parë të këtij viti. Është krijuar tashmë një sistem për menaxhimin e rasteve, i cili lehtëson qasjen e të kthyerve në shërbimet riintegruese. Data përfundimtare për kualifikim mbetet korriku i vitit 2010, por ata që janë larguar nga Kosova pas kësaj date gjithashtu mund të përfitojnë pas kthimit nga vendi nikoqir me shërbime të emergjencës, të tilla si transporti, strehimi dhe asistenca mjekësore. Individët e marginalizuar përfitojnë nga një gamë e tërë e shërbimeve të financuara nga ky fond pa marrë parasysh datën e largimit të tyre nga Kosova.

Në gjysmën e parë të vitit 2015, 1,542 nga 2,744 e të kthyerve janë regjistruar në sistemin për menaxhimin e rasteve (56%), dhe pas kthimit në Kosovë kanë marrë ndihmë të menjëhershme, siç është transporti, strehimi, ushqimi dhe asistenca mjekësore; 256 persona nga të regjistruarit në sistem (9%) kanë përfituar nga shërbimet e "qëndrueshme" të riintegrit, siç është asistenca për punëkërkuarit dhe mbështetja për planet e biznesit. Programet e trajnimit për të kthyerit e aftësuar dhe riintegrimi i fëmijëve në sistemin shkollor, veçanërisht nëpërmjet trajnimit gjuhësor, duhet të zhvillohet edhe më tej.

Për të qenë plotësisht në pajtim me kërkesat në fushën e riintegrit, Fondi për Ri-integrim duhet të disbursohet plotësisht, me një fokus në ofrimin e asistencës në punësim, krijim të bizneseve të vogla, trajnim profesional dhe trajnim gjuhësor për fëmijët.

**10) Të hartojë dhe komunikojë me kohë statistika të hollësishme për riintegrimin e të kthyerve, te autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare, Komisionit Evropian dhe EULEX-it: PLOTËSUAR**

Ndarja e informacionit dhe shkëmbimi i statistikave mbi riintegrimin mes Kosovës, Komisionit dhe EULEX-it mbetet i kënaqshëm.

**BLLOKU 1: SIGURIA E DOKUMENTEVE**

Kosova ka plotësuar **tetë nga nëntë kërkesat** në fushën e sigurisë së dokumenteve.

**11) Të lëshojë dokumente personale biometrike të udhëtimit në pajtueshmëri me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ONAC) dhe standardet e BE-së për shenjat e sigurisë dhe të dhënat biometrike në dokumentet e udhëtimit dhe të bëhen përpjekje për të gjetur mënyra të mundshme të bashkëpunimit, nëpërmjet kanaleve përkatëse, me platformën e njohur si Public Key Infrastructure të ONAC-ut: PLOTËSUAR**

Karakteristikat e sigurisë së dokumenteve personale të udhëtimit janë të kënaqshme. Këto dokumente janë në përputhje me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil dhe të BE-së mbi sigurinë e dokumenteve.

**12) Të miratojë dhe zbatojë masa për garantimin e integritetit dhe sigurisë të procesit të gjendjes civile dhe regjistrimit civil, duke përfshirë edhe integrimin dhe lidhjen e bazave të të dhënave përkatëse dhe verifikimin e të dhënave të skanuara kundrejt bazës së të dhënave të gjendjes civile, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndryshimit të të dhënave personale themelore të individëve: PJESËRISHT E PLOTËSUAR**

Kosova vazhdon të zbatojë kornizën e saj ligjore mbi sigurinë e dokumenteve, të përbërë nga ligji për dokumentet e udhëtimit, ligji mbi identitetin, ligji për emrat personal dhe ligji për gjendjen civile.

Sistemi i regjistrimit të gjendjes civile të Kosovës (SRGjC) është përmirësuar në masë të madhe. Puna e vazhdueshme ka për qëllim krijimin e një bazë të vetme qendrore të të dhënave që bashkon të dhënat nga bazat ekzistuese të të dhënave, ndërsa verifikon integritetin dhe cilësinë e të dhënave themelore. Me anë të trajnimit të duhur, është prezantuar një version i ri i SRGjC-së në korrik të vitit 2015, i cili kërkon verifikim të fuqishëm sa herë që lëshohet një certifikatë e re e gjendjes civile.

Qytetarëve iu lëshohet një Numër unik Identifikues Personal, i lidhur me të dhënat e tyre biometrike, kur kërkojnë një dokument të gjendjes civile. Kjo metodë i ka lejuar Agjencisë së Regjistrimit Civil që të verifikoj të dhënat personale të 1,602,453 qytetarëve, ose 86% të popullsisë.

Ndryshimi i emrave dhe mbiemrave rregullohet me aktet nënligjore të miratuara në maj të vitit 2015 dhe ndryshuar në nëntor të vitit 2015. Në pajtim me një kontroll të historikut penal dhe pas verifikimit se aplikuesi nuk është nën hetime penale, kërkesa duhet të miratohet nga ana e policisë dhe nga gjyqësori dhe kjo mund të bëhet vetëm një herë në pesë vite. Ndryshimet e miratuara në nëntor të vitit 2015 kane themeluar një komitet të posaçëm në Agjencinë e Regjistrimit Civil për të verifikuar kërkesat për ndryshimin e emrit në bazë të ekstrakteve nga SRGjC-ja. Në të ardhmen, ky komitet pritet të këshillojë komunat lokale mbi miratimin e kërkesave.

Për të qenë plotësisht në pajtim me kërkesat në fushën e sigurisë së dokumenteve, Kosova duhet të dëshmojë se ka zbatuar legjislacionin e saj të ndryshuar dytësor për ndryshimin e emrit.

**13) Të miratojë dhe zbatojë masa që garantojnë integritetin dhe sigurinë e procesit të aplikimit për dokumente, lëshimit dhe shpërndarjes, posaçërisht sa i përket dokumenteve personale të udhëtimit dhe letërnjoftimit, duke përfshirë letërnjoftimet biometrike: PLOTËSUAR**

Personalizimi dhe procesi i distribuimit që mbulon lëshimin e dokumenteve personale të udhëtimit, duke përfshirë letërnjoftimet biometrike, është i kënaqshëm.

**14) Të miratojë dhe zbatojë masa që garantojnë integritetin dhe sigurinë e dokumenteve sekondare, posaçërisht certifikatave të gjendjes civile, dhe letërnjoftimeve, duke përfshirë letërnjoftimet biometrike; përcaktimi dhe zbatimi i procedurave strikte për lëshimin e tyre: PLOTËSUAR**

Karakteristikat e sigurisë së dokumenteve sekondare, veçanërisht certifikatat e gjendjes civile dhe letërnjoftimet biometrike, janë në nivel të kënaqshëm. Këto dokumente janë në përputhje me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil dhe të BE-së mbi sigurinë e dokumenteve.

**15) Jepni shembuj dhe mostra të të gjitha dokumenteve valide personale të udhëtimit tek autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar dhe EULEX-it, duke komunikuar çdo ndryshim të futur në dokumentet e tilla: PLOTËSUAR**

Mostrat e tilla iu janë dhënë pikave të kalimit kufitar të Kosovës dhe autoriteteve kompetente të Shteteve Anëtare dhe janë verifikuar nga disa misione vlerësuese të BE-së.

**16) Të raportojë nëpërmes kanaleve përkatëse në bazën e të dhënave të Interpolit LASP, lidhur me dokumentet personale të udhëtimit të vjedhura ose të humbura: PLOTËSUAR**

Pasaportat e humbura dhe të vjedhura janë regjistruar dhe informatat janë transferuar tek Njësi i për Bashkëpunim Ndërkombëtare për Zbatimin e Ligjit të Kosovës (ILECU) për transmetimin e mëtejshëm. Pa anëtarësim në Interpol, Kosova nuk ka qasje në bazën e të dhënave të Interpolit mbi dokumentet e humbura dhe të vjedhura.

**17) Të fuqizojë kapacitetet e agjencisë së regjistrimit civil për kryerjen e detyrave të saj: PLOTËSUAR**

Agjencia e Regjistrimit Civil është përforcuar në masë të madhe që nga misioni i fundit vlerësues në korrik të vitit 2014, me një sere kursesh të ndërmarra të trajnimit në dy vitet e fundit. Kjo agjenci është plotësisht e aftë për kryerjen e detyrave të saj.

Në vitin 2014, Agjencia e Regjistrimit Civil ka nënshkruar memorandume të mirëkuptimit me Këshillin Prokurorial të Kosovës, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Policinë e Kosovës, Njësinë e Inteligjencës Financiare, Administratën Tatimore dhe Doganën e Kosovës për të siguruar ndërveprimin ndërmjet bazave të të dhënave të tyre respektive. Shumica e këtyre bazave të të dhënave tashmë janë të ndërlidhura.

**18) Të mbajë programe trajnuese lidhur me kundër korrupsionin dhe vendosjen e një kodi të etikës për zyrtarët e përfshirë në procesin e regjistrimit civil, aplikimit për dokumente dhe shpërndarjes: PLOTËSUAR**

Programet e tilla trajnuese janë kryer gjate viteve 2014 dhe 2015, dhe kane pasur një ndikim në aftësinë e stafit për të kryer detyrat e tyre.

**19) Të hartojë dhe komunikojë me kohë statistika të hollësishme mbi numrin e lëshuar të dokumenteve personale të udhëtimit dhe letërnjoftimeve, përfshirë letërnjoftimet tek autoritetet kompetente të shteteve anëtare, Komisionit Evropian dhe EULEX-it: PLOTËSUAR**

Shkëmbimi i informacionit në lidhje me dokumentet e udhëtimit, duke përfshirë mostrat, dhe ndryshimet në legjislacionin në mes të Kosovës, autoriteteve të Shteteve Anëtare, Komisionit dhe EULEX-it, mbetet i kënaqshëm.

## **BLLOKU 2: MENAXHIMI I KUFIRIT/KUFIRIT ADMINISTRATIVE DHE MIGRACIONIT**

### **Menaxhimi i kufirit/kufirit administrativ**

Kosova ka plotësuar katërmbëdhjetë nga pesëmbëdhjetë kërkesat në fushën e menaxhimit të kufirit/kufirit administrativ, duke përfshirë përgjegjësitë e transportuesve.

**20) Të harmonizojë me *acquis* të BE-së dhe të zbatojë legjislacionin mbi menaxhimin e integruar të kufirit/kufirit administrativ (MIK), përfshirë dispozitat e reja ligjore lidhur me bashkëpunimin ndër-institucional ndërmjet autoriteteve kompetente të përfshira në MIK: PLOTËSUAR**

Kosova ka zbatuar dhe vazhdon të zbatojë ligjin e saj për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufijve. Bashkëpunimi ndërmjet agjencive në mes autoriteteve relevante është përmirësuar në masë të madhe gjatë rrjedhës së dialogut të vizave dhe konsiderohet i kënaqshëm.

Legjislacioni i Kosovës është në mase të madhe në përputhje me *acquis* të Shengenit, dhe kontrollet kryhen në përputhje me standardet e BE-së.

**21) Të zbatojë marrëveshjet ekzistuese bilaterale në fushën e menaxhimit të kufirit/kufirit administrativ, dhe nëse është e nevojshme, të nënshkruaj marrëveshje të reja për menaxhimin e kufirit/kufirit administrativ: PLOTËSUAR**

Kosova ka arritur një game të bashkëpunimit rreth zbatimit të ligjit me partnerët kyç rajonal dhe Shtetet Anëtare të BE-së, shumë prej të cilëve rregullojnë luftën kundër migracionit të parregullt dhe kontrabandimit të emigrantëve. Bashkëpunimi me vendet fqinje është përmirësuar.

**22) Të zbatojë në mënyrë të koordinuar me palën tjetër, Protokollin Teknik për zbatimin e Konkluzioneve të Arritura për MIK të dialogut të 2 dhjetorit 2011: PLOTËSUAR**

Themelimi i pikë-kalimeve të përbashkëta të MIK-ut ka përfunduar, nën lehtësimin e BE-së, në bazë të Konkluzioneve të Arritura të MIK-ut nga Dialogu i 2 dhjetorit 2011. Pikë-kalimet e përkohshme janë plotësisht funksionale, kontrollojnë qarkullimin e mallrave dhe personave. Është bërë përparim i mirë në krijimin e pikë-kalimeve të përhershme.

**23) Të bëjë përpjekje për përfundimin e demarkacionit të kufirit/kufirit administrativ me Malin e Zi, në mënyrë të koordinuar me palën tjetër: PJESËRISHT e PLOTËSUAR**

Kosova ka nënshkruar një marrëveshje për demarkacionin e kufirit / kufirit administrativ me Malin e Zi në gusht të vitit 2015.

Për të qene në përputhje të plotë me kërkesat në fushën e menaxhimit të kufirit / kufirit administrativ, Kosova duhet të ratifikojë këtë marrëveshje me Malin e Zi para se të hiqet regjimi i vizave për qytetarët e Kosovës.

**24) Të miratojë dhe zbatojë strategjinë e re për MIK dhe planin e veprimit: PLOTËSUAR**

Kosova vazhdon të zbatojë strategjinë dhe planin e saj të veprimit të përditësuar mbi MIK-un.

**25) Të përmirësojë kontrollin e kufirit/kufirit administrativ (ndalimet dhe vëzhgimet) në dhe ndërmjet pikave të kalimit të kufirit/kufirit administrativ, me theks të veçantë nëpërmes rritjes së analizës së rreziqeve dhe inteligjencës kriminale, për të siguruar kontrollin e një personi, veturave dhe mallrave që kalojnë kufirin/kufirin administrativ dhe vëzhgim efektiv ndërmjet të gjitha pikave kufitare/kufirit administrativ: PLOTËSUAR**

Pikë-kalimet kufitare / e kufirit administrativ janë të pajisura në mënyrë të mjaftueshme për të kryer kontrollet e linjës së parë dhe të dytë, me përjashtim të pikë-kalimit në Merdarë, ku pika e përhershme e kalimit të MIK-ut është duke u vendosur.

Autoritetet përkatëse kanë personel të duhur për të kontrolluar flukset e trafikut dhe lëvizjet e

pasagjerëve. Të gjitha autoritetet përkatëse janë të informuara mbi situatën e krimeve të ndërlidhura me kufirin/kufirin administrativ, edhe pse numri i zbuluar dhe i hetuar i rasteve të migrimit të lehtësuar të parregullt, trafikimi i qenieve njerëzore dhe trafikut të drogës mbetet i ulët.

Në përputhje me rekomandimet e misionit të ekspertëve në korrik të vitit 2015, autoritetet e Kosovës ri-vendosen në mes të nëntorit 2015 kontrollimet dalëse në pikën kryesore kufitare /kufirit administrativ me Shqipërinë.

**26) Aty ku është e mundur, të ndërtohen pika të përbashkëta të kalimit të kufirit/kufirit administrativ për kontroll dhe vëzhgim të koordinuar të personave, veturave dhe mallrave që kalojnë kufirin/kufirin administrativ, përfshirë përmes njësive statike dhe mobile dhe operacioneve të koordinuara të monitorimit dhe patrullimit: PLOTËSUAR**

Krijimi i pikë-kalimeve të përbashkëta të MIK-ut ka përfunduar, nën lehtësimin e BE-së, në bazë të konkluzioneve të dakorduara të MIK-ut nga Dialogu i 2 dhjetorit 2011. Pikë-kalimet e përkohshme janë plotësisht funksionale, kontrollojnë qarkullimin e mallrave dhe personave. Është bërë përparim i mirë në krijimin e pikë-kalimeve të përhershme.

**27) Të rritet parandalimi, zbulimi dhe hetimi i krimeve të rënda ndërkufitare, posaçërisht trafikimi i qenieve njerëzore, lehtësimi i migracionit të parregullt, trafikimi i narkotikëve dhe prekursorëve, trafikimi i armëve dhe krimeve të kryera nga grupe endacake kriminale, përmes shkëmbimit të informacioneve të nevojshme strategjike dhe operative dhe inteligjencës kriminale me autoritetet kompetente të zbatimit të ligjit të Shteteve Anëtare dhe vendeve të treta, në pajtim me rregullat vendore të mbrojtjes së të dhënave dhe përmes kanaleve përkatëse: PLOTËSUAR**

Autoritetet kompetente janë të pajisura në mënyrë të duhur për të kryer mbikëqyrjen e kufirit; Analiza e riskut përdoret për të monitoruar zonat me rrezik të lartë, por zbulimet mbeten të ulëta. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë ka përfituar qasje në internet.

Shkëmbimi i të dhënave operative dhe strategjike ndërmjet autoriteteve përkatëse të zbatimit të ligjit, nën kontrollin e koordinatorit të MIK-ut, ka shënuar përmirësim të lartë.

**28) Të fuqizohen kapacitetet e qendrës koordinuese vendore për koordinimin e bashkëpunimit operacional ndërmjet autoriteteve vendore të përfshira në MIK, duke përfshirë vëzhgimin e kufirit: PLOTËSUAR**

Qendra koordinuese e MIK-ut ka përmirësuar në masë të madhe aftësitë e saj, gjatë rrjedhës së dialogut të vizave, për të koordinuar shkëmbimin e informatave operationale dhe strategjike dhe bashkëpunimin operacional ndërmjet autoriteteve përkatëse të zbatimit të ligjit.

Qendra e MIK-ut e Kosovës është plotësisht funksionale. Ajo përbëhet nga stafi i të gjitha autoriteteve relevante dhe është përgjegjës për analizat strategjike dhe operationale të rrezikut në nivel qendror, shkëmbimin e informacionit dhe mbrojtjen e të dhënave. Në nivel lokal, analiza e riskut kryhet në pikat e kalimit kufitar.

**29) Në bazë të dispozitave të reja ligjore, të shtohet bashkëpunimi ndërinstitucional ndërmjet të gjitha autoriteteve kompetente të përfshira në MIK dhe të fuqizojë kapacitetet e tyre për kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë efektive dhe të pavarur: PLOTËSUAR**

Bashkëpunimi operacional ndërmjet autoriteteve përkatëse të zbatimit të ligjit, nën kontrollin e koordinatorit të MIK-ut, është përmirësuar në masë të madhe gjatë rrjedhës së dialogut për viza.



**30) Në pajtim me rregullat vendore për mbrojtjen e të dhënave personale, të përmirësojë qasjen e të gjitha autoriteteve kompetente të përfshira në MIK në sistemin ekzistues të menaxhimit të kufirit/kufirit administrativ dhe të dhënat e proceduarat nga qendrat nacionale koordinuese: PLOTËSUAR**

Sistemi i menaxhimit të kufijve në Kosovë është i qasshëm për të gjitha autoritetet përkatëse të zbatimit të ligjit dhe vepron në nivel të kënaqshëm.

**31) Të mbajë programe trajnuese në fushën kundër korrupsionit dhe luftimit të krimit të organizuar dhe të vendosë një kod të etikës për zyrtarët e përfshirë në MIK: PLOTËSUAR**

Kjo kërkesë tashmë ishte plotësuar në vitin 2014.

**32) Të hartojë dhe komunikojë me kohë statistika të hollësishme lidhur me masat e kontrollit të kufirit/kufirit administrativ, duke përfshirë numrin e koordinuar të monitorimit dhe operacioneve patrulluese tek autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare, Komisionit Evropian dhe EULEX-it: PLOTËSUAR**

Kosova vazhdon të shkëmbej statistikat me Shtetet Anëtare, Komisionin dhe EULEX-it mbi operacionet e patrullimit të kufirit.

**33) Të hulumtojë modalitetet e bashkëpunimit me FRONTEX: PLOTËSUAR**

Bashkëpunimi i Kosovës me FRONTEX është përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme. Shkëmbimet në nivel të stafit u zhvilluan në mes të FRONTEX dhe Kosovës në vitin 2014, dhe Bordi Menaxhues i FRONTEX ka konsideruar edhe avancimin e bashkëpunimit me Kosovën.

#### **Përgjegjësitë e transportuesve**

**34) Të miratojë dhe zbatojë masa që përcaktojnë përgjegjësitë ligjore të transportuesve, përfshirë dënimet financiare, për kthimin e shtetasve të vendeve të treta të cilët nuk i plotësojnë kushtet për hyrje në Kosovë: PLOTËSUAR**

Përgjegjësia e transportuesve është e rregulluar në mënyrë të duhur me ligjin për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufijve. Ajo është zbatuar plotësisht.

#### **Menaxhimi i migracionit**

Kosova ka plotësuar të gjitha dhjetë kërkesat në fushën e menaxhimit të migracionit.

**35) Të miratojë dhe zbatojë legjislacionin për migracionin legal në pajtueshmëri me *acquis* të BE-së: PLOTËSUAR**

Legjislacioni i Kosovës në menaxhimin e migracionit - ligji për të huajt, ligji për dhënien e lejeve të punës, ligji për familjen, ligji për arsimin e lartë, ligji i punës, ligji për arsimin e të rriturve dhe të ligjit për procedurat administrative – është në përputhje me *acquis* të BE-së. Kjo kornizë komplekse ligjore është duke u zbatuar.

Sistemi Informativ i Vizave të Kosovës (SIVK) është vendosur në 15 prej 30 misionëve diplomatike apo konsullorë të Kosovës jashtë vendit. 15 misionet e mbetura që nuk janë të lidhura me SIVK janë të vendosura zakonisht në Shtetet Anëtare të BE ose Shtetet Anëtare të Zonës Shengen, ku të paktën një post konsullor, në mënyrë tipike një në kryeqytet, tashmë është i lidhur me këtë sistem. Për shkak se përfaqësimit të kufizuar diplomatik të Kosovës në mbarë botën, SIVK është në dispozicion vetëm në disa kryeqytete amerikane, afrikane apo aziatike. Për të bërë këtë sistem të qasshëm për të gjithë shtetasit e vendeve të treta të cilët

kërkojnë një vizë për të hyrë në Kosovë,<sup>6</sup> autoritetet e Kosovës kanë filluar kontraktimin e aplikacioneve për viza tek ofruesit e shërbimeve të jashtme duke ruajtur kontrollin mbi vendimet e vizave. Ky proces duhet të vazhdojë.

Në përputhje me Kodin e Kufijve të Shengen, vizat jepen vetëm në kufijtë e Kosovës në rrethana të jashtëzakonshme.<sup>7</sup>

### **36) Të miratojë dhe zbatojë legjislacionin mbi migracionin e parregullt në pajtueshmëri me *acquis* të BE-së: PLOTËSUAR**

Ligji për të huajt përcakton që të huajt mund të hyjnë dhe të qëndrojnë në territorin e Kosovës në qoftë se ata mbajnë një dokument të vlefshëm udhëtimi që përfshin një vizë të vlefshme ose leje për qëndrim të përkohshëm. Ajo gjithashtu rregullon kthimin e emigrantëve të parregullt dhe paraburgimin para largimit. Në vitin 2013, Kosova ka vendosur ndryshime ligjore që përcaktojnë procedura për një politikë të drejtë dhe transparente të kthimit, duke përfshirë dispozitat për vendimet e kthimit, largimin, ndalimet e hyrjes, arratisjen, largimin vullnetar dhe personat e marginalizuar. Procedura e kthimit është e rregulluar tanimë; janë zhvilluar masat mbrojtëse procedurale.

Ligji për të huajt përcakton se urdhrat për largim duhet të shoqërohen me një ndalim të hyrjes. Rregullat e ndryshuara mbi paraburgimin përcaktojnë autoritetet kompetente, kushtet e paraburgimit, kontaktet me përfaqësuesit ligjor ose anëtarët e familjes dhe trajtimin e personave të marginalizuar. Parimi i *mos-kthimit* është përfshirë në ligjin për të huajt. Kjo kornizë ligjore është duke u zbatuar.

Në vitin 2014, Kosova ka lëshuar 77 leje qëndrimi për të huajt. Pasi që integrimi i të huajve është ende në fillimet e saj, Kosova duhet të fus në këtë fushë përvojën që ka marrë në drejtimin e programit të saj për riintegrim.

### **37) Të zbatojë strategjinë dhe planin e veprimit për migracion; të bëjë rishikimin e këtyre dokumenteve, nëse është e nevojshme të sigurohet veprim efektiv; dhe të caktohen tregues të qartë për matjen e performancës në këtë fushë: PLOTËSUAR**

Kosova vazhdon të zbatoj strategjinë dhe planin e saj të veprimit të përditësuar mbi menaxhimin e migrimit.

### **38) Të zhvillojë bazën e të dhënave për migracion dhe të sigurojë qasje për të gjitha autoritetet e përfshira në menaxhimin e migracionit, në pajtim me rregullat vendore të mbrojtjes së të dhënave: PLOTËSUAR**

Kosova ka zhvilluar një bazë të tillë të të dhënave mbi migracionin dhe azilin. Bazat e ndryshme të të dhënave në zbatimin e ligjit dhe migracionit janë duke u ndërlidhur.<sup>8</sup>

### **39) Të krijojë dhe aplikojë një mekanizëm për monitorimin e lëvizjeve së migracionit; të përcaktojë një profil të rregullt-të përditësuar të migracionit për Kosovën, me të dhëna lidhur me migracionin legal dhe të parregullt; dhe, të krijojë një autoritet**

<sup>6</sup> Qytetarëve të 88 shteteve iu kërkohet vizë për të hyrë në Kosovë. Qytetarët e Shteteve Anëtare të BE-së dhe Shteteve Anëtare të Zonës Shengen janë të liruar nga kërkesa për vizë. Shtetasit e vendeve të treta t cilëve iu kërkohet vizë për të hyrë në Kosovë mund ta bëjnë këtë për pesëmbëdhjetë ditë në qoftë se ata kanë një vizë të vlefshme Shengen me shumë hyrje. Këto dispozita gjithashtu zbatohet ndaj personave që mbajnë dokumente udhëtimi për refugjatë dhe persona pa shtetësi.

<sup>7</sup> Gjatë periudhës tetor 2014 - tetor 2015, vetëm 8 vizat janë lëshuar në pikë-kalimet kufitare / kufirin administrativ të Kosovës.

<sup>8</sup> Këto sisteme përfshijnë si në vijim: sistemin e menaxhimit të kufirit (BMS), sistemin informativ të Policisë së Kosovës (SIPK), sistemin informativ të vizave të Kosovës (SIVK), sistemin e regjistrimit të gjendjes civile (SRGjC) dhe sistemin për menaxhimin e rasteve për të kthyerit, si dhe bazën e të dhënave për azil dhe migracion.

**publik përgjegjës për grumbullimin dhe analizimin e të dhënave mbi ofrimin dhe lëvizjet e migracionit: PLOTËSUAR**

Profili i zgjeruar i migrimit të Kosovës është i zhvilluar mirë. Ajo mund të rafinohet më tutje duke përfshirë informacion në lidhje me diasporën e Kosovës.

**40) Të definojë dhe aplikojë një metodologji për zbulime brenda vendit dhe përmirësoj kapacitetet e autoriteteve kompetente në parandalimin, zbulimin dhe hetimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe lehtësimin e migracionit të parregullt: PLOTËSUAR**

Profili i zgjeruar i migrimit të Kosovës trajton në mënyrë të duhur çështjet e kontrabandimit të emigrantëve, trafikimit të qenieve njerëzore dhe lehtësimin e migrimit të parregullt. Maturimi i këtij dokumenti, dhe përpjekjet për të zbatuar atë, pasqyrojnë gatishmërinë e Kosovës për të adresuar migracionin e parregullt në dhe nga Kosova.

**41) Të vendosë një procedurë të përshtatshme për dëbimin dhe largimin efektiv nga Kosova të shtetasve të vendeve të treta me qëndrim ilegal: PLOTËSUAR**

Kosova operon me objektet e saj të paraburgimit - një të përkohshëm në Aeroportin e Prishtinës dhe një të përhershëm në Vranidoll - në përputhje me Direktivën e Kthimit të BE-së. Të kthyerit gëzojnë masa mbrojtëse procedurale adekuate dhe qasje në shërbime, siç kërkohet nga Direktiva për Kthim. Një fletëpalosje që përshkruan masat mbrojtëse procedurale për të kthyerit duhet të vihet në dispozicion në të dy objektet.

**42) Të mbaj programeve trajnuese lidhur me kundër-korrupsionin dhe të vendos një kod të etikës për zyrtarët e përfshirë në politikatat e migracionit: PLOTËSUAR**

Kosova ka zhvilluar disa programe trajnimi për zyrtarët e përfshirë në menaxhimin e migrimit.

**43) Të hartojë dhe komunikojë me kohë statistika të hollësishme për ofrimin dhe lëvizjet e migracionit legal dhe të parregullt te autoritetet kompetente të shteteve anëtare, Komisionit Evropian, dhe EULEX-it: PLOTËSUAR**

Shkëmbimi i informacionit me Shtetet Anëtare, Komisionin dhe EULEX-in në menaxhimin e migracionit mbetet i kënaqshëm. Profili i migrimit të Kosovës është zhvilluar me inpute të detajuara nga akterët e BE-së dhe nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim.

**44) Të shqyrtojë mënyrat e bashkëpunimit me iniciativat rajonale për migracionin, azilin dhe refugjatët: PLOTËSUAR**

Kosova ka bere përpjekje të përmirësoj marrëdhëniet me iniciativat rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatët.

## Azili

Kosova ka plotësuar **gjashtë nga shtatë kërkesat** në fushën e azilit.

### **45) Të harmonizohet me *acquis* të BE-së dhe të zbatojë legjislacionin mbi azilin; PLOTËSUAR**

Ligji i Kosovës për azil është në harmoni me *acquis* të BE-së, pasi një grup i amendamenteve është miratuar në vitin 2013 për të qenë në përputhje me rekomandimet e Komisionit. Kosova ka strukturën institucionale dhe burimet e nevojshme për të ofruar mbrojtje ndërkombëtare për azil-kërkuesit.

### **46) Të fuqizojë kapacitetet e autoriteteve kompetente në përmbushjen e detyrave të tyre, në veçanti sa i përket kushteve të pranimit dhe procedurave të azilit; PJESËRISHT E PLOTËSUAR**

Sipas UNHCR-it, 62 dhe 98 persona kanë kërkuar azil në Kosovë, përkatësisht në vitin 2013 dhe 2014, katër aplikantë kanë pranuar mbrojtje plotësuese në vitin 2013; një në vitin 2014. Përderisa rruga e migrimit e Ballkanit Perëndimor deri më tani e ka anashkaluar, Kosova duhet t'i vë në përdorim objektet e saj për t'i dhënë mbrojtje ndërkombëtare atyre që e meritojnë.

Të pajtohet plotësisht me kërkesat në fushën e azilit, Kosova duhet të monitoroj arsyet e normës së saj të ulët të njohjes për azil-kërkuesit.

### **47) Të përmirësojë kushtet ekzistuese materiale, dokumentacionin dhe shërbimet tjera publike në dispozicion për azil-kërkuesit, duke përfshirë personat me nevoja të veçanta: PLOTËSUAR**

Kushtet e pranimit për azil-kërkuesit, duke përfshirë edhe për personat e marginalizuar, janë përmirësuar që nga viti 2013 si rezultat i zbatimit të ligjit të ri mbi azilin.

Kosova ka përmirësuar bashkëpunimin me UNHCR-in në vitin 2015, sidomos në fushën e përkthimit në distancë. Ajo ka hartuar listën e saj të përkthyesve dhe ka lidhur një marrëveshje me UNHCR-në për të shfrytëzuar burimet e saj të përkthimit nga distanca për gjuhët që Kosova nuk i mbulon.

### **48) Të garantojë pavarësinë dhe ngritjen e kapaciteteve të autoriteteve mbikëqyrëse të ngarkuara me azilin: PLOTËSUAR**

Struktura institucionale përgjegjëse për regjistrimin e azil-kërkuesve, të cilët ofrojnë kushte të pritjes materiale dhe mbikëqyrin zbatimin e ligjit të Kosovës mbi azilin, mbetet e kënaqshme. Megjithatë, siç u përmend më lart, Kosova monitoron arsyet për normën e saj të ulët të njohjes për azil-kërkuesit.

### **49) Të mbaj programe të trajnimit lidhur me kundër korrupsionin dhe të vendos një kod të etikës për zyrtarët e përfshirë në politikat e azilit: PLOTËSUAR**

Programet e tilla të trajnimit janë kryer që prej vitit 2013, megjithatë, programet e mëtejshme të trajnimit për njohjen e zyrtarëve të Kosovës me sistemin e Sistemi të Përbashkët Evropian për Azilin e BE-së do të ishin të dobishme.

### **50) Të hartojë dhe komunikojë me kohë statistika të hollësishme për azilin tek autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare, Komisionit Evropian dhe EULEX-it; PLOTËSUAR**

Shkëmbimi i informacionit dhe statistikave për azilin ndërmjet Kosovës dhe Shteteve Anëtare, Komisionit dhe EULEX-it mbetet i kënaqshëm.

### **51) Të shqyrtojë mundësitë e bashkëpunimit me EASO: PLOTËSUAR**

Kosova ka kërkuar të vendos marrëdhënie më të ngushta me EASO, me sukses të kufizuar përtej kontrollit të saj.

### **BLLOKU 3: RENDI PUBLIK DHE SIGURIA**

#### **Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar, korrupsionit dhe terrorizmit**

Kosova ka plotësuar **dymbëdhjetë nga pesëmbëdhjetë kërkesat** në fushën e luftimit të krimit të organizuar, korrupsionit dhe terrorizmit.

**52) Të miratojë dhe zbatojë legjislacionin për parandalimin, hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, duke përfshirë shpëlarjen e parave dhe krimit financiar, konfiskimin dhe kthimin e asetëve, si dhe financimin e terrorizmit, në pajtim me *acquis* të BE-së, duke siguruar se ndryshimet në këtë legjislacion po ashtu janë reflektuar në kodin penal: **PLOTËSUAR****

Kodi i ri penal i Kosovës dhe kodi i procedurës penale ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2013 dhe janë duke u zbatuar në praktikë.

Në qershor të vitit 2015, Kuvendi ka miratuar ndryshimet për katër ligjet<sup>9</sup> kryesore që mbështesin sistemin e të drejtës penale të Kosovës. Këto ndryshime kanë harmonizuar kriteret për emërimin e gjykatësve dhe shkarkimin e gjykatësve dhe prokurorëve, përfundimin e pavarësisë së tyre duke iu dhënë atyre kompetenca për propozimin e buxheteve të tyre. Vendet e lira të punës aktualisht janë duke u plotësuar në Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe në Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK).<sup>10</sup>

Pjesë tjera qendrore të legjislacionit në fushën e luftimit të krimit të organizuar, korrupsionit dhe terrorizmit përfshijnë ligjin mbi prokurorinë speciale, ligjin mbi policinë, ligjin për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, ligjin për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar. Këto ligje janë duke u zbatuar nga institucionet përkatëse.

Përpjekjet e Kosovës kundër terrorizmit vazhdojnë të jenë funksionale. Luftëtarët e huaj vazhdojnë të mbesin shqetësime; Autoritetet e Kosovës kanë mbledhur informacione të mjaftueshme për luftëtarët kosovarë në Siri. Ligji i marsit 2015 për ndalimin e pjesëmarrjes në konflikte të armatosura jashtë vendit, është duke u zbatuar. Qeveria ka rritur dukshëm përpjekjet e saj për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin në Kosovë, veçanërisht duke marrë mbështetjen e liderëve islamikë.

Kosova është duke adresuar trafikimin e armëve, megjithatë, shkalla e shkatërrimit të armëve të vogla mbetet e ulët. Për të rritur efektivitetin e përpjekjeve të saj kundër trafikimit të armëve të zjarrit, Kosova duhet t'i japë përparësi zbatimit të veprimeve të dakorduara në Planin e Veprimit për trafikimin e paligjshëm të armëve të zjarrit në mes BE-së dhe rajonit të Evropës Juglindore.

**53) Të miratojë dhe zbatojë legjislacionin për parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e trafikimit të qenieve njerëzore, duke përfshirë shfrytëzimin seksual të fëmijëve, në pajtim me *acquis* të BE-së; 17 të sigurojë hetimin dhe ndjekjen proaktive e trafikimit me qenie njerëzore, duke përfshirë dënimet bindëse për individët që janë shpallur fajtorë në këtë krim serioz; të shtojë efikasitetin e identifikimit të viktimave: **PLOTËSUAR****

<sup>9</sup> Ligji mbi Gjykatat, Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Ligji për Prokurorin

<sup>10</sup> Nga 171 pozita në prokurori, KPK-ja ka plotësuar 157 pozita. Aktualisht është duke u bërë gati konkursi për rekrutimin e 15 prokurorëve nga minoritetet.

Në kontekstin e dialogut të vizave, në vitin 2013, Kosova ka miratuar një ligj për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit. Ky ligj është zbatuar që nga gushti i vitit 2013. Kosova ka shtuar përpjekjet e saj për të rehabilituar viktimat dhe parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore.

Përgjigja e Kosovës ndaj trafikimit të qenieve njerëzore dhe kontrabandimit të emigrantëve është e pranueshme. Policia ka një numër të mjaftueshëm të personelit për të hetuar krimet që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore dhe kontrabandimit të emigrantëve. Pas krizës së jashtëzakonshme të migrimit nga Kosova, në fund të vitit 2014 dhe fillim të vitit 2015, Kosova ka shtuar kontrollin e kompanive të autobusëve që zakonisht kanë lehtësuar kontrabandimin e emigrantëve. Përderisa, rruga e migrimit të Ballkanit Perëndimor deri tani ka anashkaluar Kosovën, ajo ka forcuar bashkëpunimin për zbatimin e ligjit me Serbinë, Hungarinë dhe Austrinë.

**54) Të miratojë dhe zbatojë legjislacionin për parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e trafikimit më narkotikë dhe prekursorë, në pajtueshmëri me *acquis* të BE-së; të sigurojë hetimin dhe ndjekjen proaktive të këtyre krimeve; PLOTËSUAR**

Krahas kornizës së përgjithshme penale të përshkruar më lart, legjislacioni i Kosovës në luftën kundër narkotikëve dhe prekursorëve përfshin ligjin për barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorët, si dhe ligjin për produkte dhe pajisje medicinale. Të dy pjesët e legjislacionit janë duke u zbatuar.

Kosova ka arritur progres në luftimin e trafikimit të narkotikëve. Ka konfiskuar sasi të shtuar të marihuanës, heroinës dhe kokainës në vitin 2013 dhe 2014. Kosova ka arritur një sërë memorandumesh të mirëkuptimit me partnerët kryesorë dhe merr pjesë nëpërmjet Njësisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zbatimin e Ligjit, (ILECU), në “Rrugën e Ballkanit Perëndimor” dhe “Ekipin e Përbashkët Hetimor në Ballkan” të udhëhequr nga Evropa kundër trafikimit të drogës. Shumica e rasteve të krimeve të organizuara të hetuara nga policia kanë të bëjnë me trafikimin e drogës, edhe nëse dënimet përfundimtare në rastet e ndërlidhura me trafikimin e drogave mbesin të ulëta.

**55) Të zbatojë strategjitë dhe planet e veprimit për luftimin e krimit të organizuar, korrupsionit, trafikimit me qenie njerëzore, trafikimit me droga dhe prekursorë, kundër terrorizmit, parandalimit të krimit dhe trafikimit me armë; të rishikojë këto dokumente, nëse është e nevojshme të përcaktojë veprime efektive; dhe të vendos tregues të qartë për matjen e performancës në këto fusha: PLOTËSUAR**

Kosova ka zbatuar një grup të strategjive të përditësuara dhe plane të veprimit në fushën e luftimit të krimit të organizuar, korrupsionit dhe terrorizmit, sidomos strategjinë e saj të sigurisë, strategjinë dhe planin e veprimit të saj në luftën kundër krimit të organizuar, strategjinë dhe planin e veprimit kundër terrorizmit, strategjinë dhe planin e veprimit në luftën kundër shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, strategjinë dhe planin e veprimit në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, strategjinë e saj anti-drogë, strategjinë e saj mbi policimin e udhëhequr nga inteligjenca, strategjinë dhe planin e veprimit për armët e vogla dhe të lehta, si dhe strategjinë dhe planin e veprimit për parandalimin e krimit.

**56) Të realizojë hetime proaktive të pasurisë së pazakonshme/të dyshimtë; të vendos një sistem të mirë kundër shpëlarjes së parave; dhe të zhvillojë dhe zbatojë një sistem solid për konfiskimin dhe menaxhimin e aseteve: PJESËRISHT E PLOTËSUAR**

Kosova ka shënuar progres në ngrirjen dhe konfiskimin e pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme, por vetëm një pjesë e vogël e këtyre pasurive është konfiskuar.<sup>11</sup> Në mungesë të numrit të mjaftueshëm të urdhrave të konfiskimit, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar (AAPSK) është e detyruar të menaxhojë, për kohë të pacaktuar, pasuritë e konfiskuara nga zbatimi i ligjit. Ligji i vitit 2013 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë duhet të shfrytëzohet plotësisht.

Strategjia e qeverisë së vitit 2014 për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit është zbatuar, por dënimet për shpëlarjen e parave mbeten të ulëta.

Për të qenë plotësisht në pajtim me kërkesat në fushën e luftimit të krimit të organizuar, korrupsionit dhe terrorizmit, Kosova duhet të mbaj një regjistër të hetimeve, aktgjykime finale të gjykatave dhe konfiskimeve në raste të rënda të krimeve të organizuara dhe korrupsionit, sidomos duke i dhënë koordinatorit qendror për rastet e rënda të krimit të organizuar dhe rastet e korrupsionit, mandatin dhe burimet e nevojshme për të udhëhequr ekipe multidisiplinare të hetimeve financiare dhe të monitoroj përcjelljen gjyqësore për raste të tilla.

**57) Të fuqizojë kapacitetet e policisë dhe njësisë përgjegjëse për inteligjencë financiare për të kryer në mënyrë efektive dhe të pavarur hetime komplekse të krimit të organizuar dhe korrupsionit, duke përfshirë shpëlarjen e parave dhe krimeve ekonomike dhe financiare: PLOTËSUAR**

Ju lutem referojuni vlerësimin nën kërkesën 56.

**58) Të fuqizojë kapacitetet e policisë për zbulim dhe hetim, prokurorëve për ndjekje dhe gjykatësve për gjykim, në mënyrë të pavarur, të rasteve të rënda të krimit të organizuar, korrupsionit, krimit ekonomik dhe financiar dhe terrorizmit; të zhvillojë historik/regjistër të hetimeve dhe aktgjykimeve finale të gjykatave lidhur me krimin e organizuar dhe korrupsionin, duke përfshirë trafikimin me narkotikë, trafikimin me qenie njerëzore dhe shpëlarje të parave: PJESËRISHT E PLOTËSUAR**

Regjistri i Kosovës për gjykimin e rasteve të rënda të krimit të organizuar dhe korrupsionit mbetet i dobët, pjesërisht për shkak të problemeve me kapacitete që ndikojnë në gjyqësor.<sup>12</sup>

<sup>11</sup> Në vitin 2014, asetet në vlerë prej 30 milionë Euro ishin ngrirë, por vetëm 128,000 janë konfiskuar. Në gjysmën e parë të vitit 2015, 27,000 Euro janë konfiskuar nga asetet në vlerë prej 16 milionë Euro sipas urdhrat për ngrirje apo sekuestrim

<sup>12</sup> Prokuroria ka paraqitur akuza të ndërlidhura me krimin e organizuar në 2 raste në vitin 2013; 8 raste në vitin 2014; dhe 3 raste në gjysmën e parë të vitit 2015. Ata kanë paraqitur akuza në 314 raste të korrupsionit në vitin 2013; 444 raste në vitin 2014; dhe 128 raste në gjysmën e parë të vitit 2015. Nuk ka të dhëna në lidhje me dënimet përfundimtare në këto raste

Për ta përmirësuar këtë, kryeprokurori i emëruar në tetor të vitit 2015, ushtrues i detyrës të udhëheqësit të prokurorisë speciale si koordinatori qendror për përzgjedhjen dhe synimin e rasteve të rënda të profilit të lartë të krimit të organizuar dhe korrupsionit. Kosova tani duhet të marrë parasysh financimin e zyrës së koordinatorit qendror me mandatin dhe burimet për udhëheqjen e ekipeve multi-disiplinore, të përbëra nga prokurorët special, policët, zyrtarët e doganave dhe zyrtarët tatimor, për kryerjen e hetimeve financiare dhe monitorimin e përcjelljes gjyqësore të rasteve të profilit të lartë të krimit të organizuar dhe korrupsionit, duke përfshirë ngrirjen dhe konfiskimin e aseteve, zbatimin e urdhrave për konfiskim dhe kthimin e aseteve të fituara në mënyrë të paligjshme tek shoqëria.

Në tetor të vitit 2015, KGJK-ja ka transferuar tre gjykatës në departamentin e krimeve të rënda të Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke arritur në një numër të përgjithshëm të gjykatësve prej 14. Ky zhvillim i mirëpritur duhet të zgjerohet në të gjitha departamentet e krimeve të rënda në gjykatat në Kosovë. Nxitja e mëtejshme e burimeve njerëzore të departamenteve të krimeve të rënda të gjykatave themelore, përfshirë personelin e kualifikuar dhe personelin mbështetës me buxhet të duhur, duhet të bëhet prioritet për Kosovës.

Në vitin 2014, KGJK-ja ka miratuar strategjinë për zvogëlimin e rasteve të grumbulluara në gjykata, e cila synon, deri në fund të vitit 2016, të përmbaroj shumicën e vendimeve në konteste administrative<sup>13</sup>. KGJK-ja duhet tani të prioritetizojë burimet e pakta në atë mënyrë që gjykatësit në departamentet e krimeve të rënda, me personelin e duhur mbështetës, mund të fokusohen në gjykimin e rasteve të rënda të krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Për të qenë plotësisht në përputhje me kërkesat në fushën e luftimit të krimit të organizuar, korrupsionit dhe terrorizmit, Kosova duhet të transferoj një numër të mjaftueshëm të gjykatësve, me stafin e duhur mbështetës, në departamentet e krimeve të rënda në të gjithë gjykatat e Kosovës.

**59) Të përmirësojë koordinimin, bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informatave dhe inteligjencës kriminale ndërmjet autoriteteve për zbatim të ligjit dhe atyre gjyqësore, posaçërisht policisë dhe prokurorisë, për të përmirësuar arritjet e Kosovës në hetimin dhe ndjekjen e rasteve të krimit të organizuar dhe korrupsionit, krimeve ekonomike dhe financiare dhe terrorizmit: PLOTËSUAR**

Kosova është duke punuar në zhvillimin e një sistemi të integruar për menaxhimin e rasteve i cili lejon ndjekjen e rasteve nga faza e inteligjencës dhe hetimeve, nëpërmjet ndjekjes penale dhe dënimeve përfundimtare për rikuperimin e pasurive. Zyra e koordinatorit qendror që është përgjegjëse për rastet e profilit të lartë të krimit të organizuar dhe korrupsionit duhet të ndërmarr hapa për të përforcuar lidhjet operationale dhe ato të TI-së ndërmjet zbatimit të ligjit dhe ndjekjes penale. Është duke u zhvilluar puna përgatitore.

Ligji i Kosovës për përgjim u miratua në maj të vitit 2015. Kjo bën dallim të qartë nga pikëpamja ligjore, procedurale dhe teknike, ndërmjet përgjimit të ligjshëm për qëllime të drejtës penale dhe mbrojtjes së sigurisë së Kosovës. Kjo pjesë e legjislacionit gjithashtu rregullon ruajtjen e të dhënave. Është duke u bërë zbatimi i kësaj pjesë thelbësore të legjislacionit.

**60) Të zbatojë legjislacionin ekzistues për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të fuqizojë kapacitetet e policisë për krijimin dhe funksionalizimin e programit për mbrojtje të dëshmitarëve: PLOTËSUAR**

---

<sup>13</sup> Nga 102,009 raste që përbënin lëndë të grumbulluara, në dhjetor të vitit 2011, Gjykatat e Kosovës arritën të dërgoj në përmbarim 25.275 raste të vjetra (ose pothuajse 25% e lëndëve të grumbulluara) në vitin 2014. Shumica e këtyre rasteve kanë kërkuar zbatimin e vendimeve në lidhje me pagesën e faturave të shërbimeve komunale. KGJK-ja planifikon të reduktojë edhe më tej lëndët e grumbulluara deri në vitin 2016, sidomos me anë të zgjidhjes alternative të kontesteve.



Mbrojtja e dëshmitarëve tanimë është funksionale në Kosovë. Drejtoria për mbrojtjen e dëshmitarëve e policisë është e plotësuar me personel në mënyrë të duhur, me një buxhet të duhur. Është arritur një numër i marrëveshjeve për ri-vendosje me vendet e treta.

**61) Të zhvillojë një bazë të qëndrueshme të të dhënave për regjistrin e veprave penale, përfshirë në baza të asistencës reciproke ligjore për çështje penale: PLOTËSUAR**

Puna për të krijuar një bazë të të dhënave elektronike për regjistrin e veprave penale është duke u zhvilluar, megjithatë të dhënat duhet të futen në sistem.

**62) Të garantojë zbatim efektiv dhe efikas të vendimeve të gjykatave: PLOTËSUAR**

Ju lutem shikoni vlerësimin nën kërkesën 58.

**63) Të vendos mekanizma efektivë për parandalimin e korrupsionit dhe për identifikimin dhe përcjelljen e rrezikut për korrupsion, duke përfshirë vlerësimet e rreziqeve në sektor më të ndjeshëm; të garantohet transparencë, integriteti dhe llogaridhënia e zyrtarëve të administratës publike dhe zyrtarëve të zgjedhur, zbulimin dhe heqjen e konflikteve të interesit, verifikimin e pasurisë së zyrtarëve publik dhe transparencën e financimit të partive politike: PJESËRISHT E PLOTËSUAR**

Prokurimi publik mbetet burim kryesor i korrupsionit në Kosovë.

Kuvendi ka miratuar një ligj të ndryshuar mbi prokurimin publik më 14 dhjetor 2015, i cili përveç çështjeve tjera ka krijuar një platformë për prokurimin elektronik dhe synon të rregullojë statusin e anëtarëve të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, i cili menaxhon prokurimin publik në Kosovë dhe Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHPP), i cili shqyrton vendimet e marra nga Komisioni. Këto ndryshime pritet të hyjnë në fuqi në janar të vitit 2016. Me pretendimet për kolizion ndërmjet OSHPP-së dhe gjyqësorit, si dhe pretendimet korruptive kundrejt udhëheqësit të OSHPP-së, është e rëndësishme që Kosova të vendos masa të duhura mbrojtëse për të garantuar pavarësinë funksionale të OSHPP-së. Duhet të zbatohen plane strikte të integritetit për mbrojtjen e pavarësisë së të dyja organeve.

Ligji i Kosovës për financimin e partive politike është vënë në përdorim gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2014. Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) tani ka personel të mjaftueshëm. Gjatë fushatës së vitit të kaluar, të gjitha partitë politike kanë dorëzuar në KQZ raportet e tyre financiare, ku disa kanë marrë gjopa për dorëzimin me vonesë të raporteve të tyre.

Për të qenë plotësisht në pajtim me kërkesat në fushën e luftimit të krimit të organizuar, korrupsionit dhe terrorizmit, Kosova duhet të sigurojë pavarësinë funksionale të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik. Duhet të zbatohen plane strikte të integritetit për të mbrojtur pavarësinë e këtij organi dhe të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.

**64) Të shtojë efikasitetin e Agjencisë Kundër Korrupsionit: PLOTËSUAR**

Agjencioni Kundër Korrupsion dhe Këshilli Kombëtar Kundër Korrupsionit, të udhëhequr nga Presidentja e Kosovës, kanë përmirësuar bashkëpunimin mes tyre. Agjencioni Kundër Korrupsion është pajisur në mënyrë të duhur me burime dhe vazhdon të shqyrtojë deklaratimet e pasurive dhe të monitoroj konfliktet e interesit në sektorin publik. Kapaciteti i Agjencionit Kundër Korrupsion është i mjaftueshëm për të siguruar pajtueshmërinë me ligjin për deklarin e pasurisë nga ana e zyrtarëve të lartë publik dhe me ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike.

**65) Të mbaj programe trajnuese për kundër-korrupsionin dhe krimin e organizuar dhe të vendoset një kod i etikës për zyrtarët publik të përfshirë në hetimin, ndjekjen dhe**

## **gjykimin e rasteve të krimit të organizuar dhe korrupsionit; PLOTËSUAR**

Kosova ka kryer një sërë programesh të trajnimit për kundër-korrupsion për zyrtarët publikë të cilët janë aktiv në zbatimin e ligjit.

**66) Të hartojë dhe komunikojë me kohë statistika të hollësishme për hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e rasteve të krimit të organizuar, korrupsionit dhe terrorizmit tek autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare, Komisionit Evropian, dhe EULEX-it: PLOTËSUAR**

Kosova ka vazhduar të shkëmbej informata dhe statistika me Shtetet Anëtare dhe Komisionin për hetimet në vazhdim e sipër të rasteve të krimeve të rënda. Shkëmbimi i informatave operacionale me EULEX-in në luftën kundër krimeve të rënda, sidomos përmes prokurorisë speciale, vazhdon të jetë i kënaqshëm.

### **Bashkëpunimi në fushën e zbatimit të ligjit**

Kosova ka plotësuar të gjitha njëmbëdhjetë kërkesat në fushën e bashkëpunimit për zbatimin e ligjit.

**67) Të zbatojë marrëveshjet ekzistuese për bashkëpunim në fushën e zbatimit të ligjit, dhe ku është e mundur të nënshkruaj marrëveshje të reja: PLOTËSUAR**

Kosova ka nënshkruar 55 memorandume të mirëkuptimit mbi bashkëpunimin në fushën e zbatimit të ligjit me 16 vende dhe EULEX-in.<sup>14</sup>

**68) Aty ku është e mundur, të vendos zyrtarë ndërlidhës për zbatim të ligjit në Shtetet Anëtare dhe vende të treta: PLOTËSUAR**

Kosova ka dërguar 7 zyrtarë ndërlidhës tek parterët kryesorë, siç është Turqia, Gjermania, Austria dhe Franca.

**69) Të rris nivelin e parandalimit, zbulimit dhe hetimit të krimeve të rënda ndërkufitare, me theks të veçantë të trafikimit me qenie njerëzore, lehtësimit të migracionit të parregullt, trafikimit me narkotikë dhe prekursorë, trafikimin me armë dhe krime të kryera nga grupe endacake kriminale, nëpërmes shkëmbimit me autoritetet kompetente të sundimit të ligjit të Shteteve Anëtare dhe vendeve të treta, në pajtueshmëri me rregullat vendore të mbrojtjes së të dhënave dhe nëpërmes kanaleve përkatëse, informatave të nevojshme strategjike dhe operative, dhe inteligjencës kriminale: PLOTËSUAR**

Shkëmbimi i informatave strategjike dhe operative bëhet përmes rrjetit të zbatimit të ligjit të Kosovës, memorandumit të mirëkuptimit dhe rrjetit të zyrtarëve ndërlidhës.

**70) Të arrij një marrëveshje me EULEX-in për shkëmbim të sigurt, të besueshëm dhe efikas të informatave strategjike dhe operative dhe inteligjencë kriminale të nevojshme për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e krimeve të rënda; të zbatojë marrëveshjet ekzistuese me EULEX-in lidhur me shkëmbimin e të dhënave për çështje tatimore dhe doganore; PLOTËSUAR**

Shkëmbimi i të dhënave strategjike dhe operacionale me EULEX-in, sidomos me anë të prokurorisë speciale, mbetet i kënaqshëm.

---

<sup>14</sup> Nga 102,009 raste që përbënin lëndë të grumbulluara, në dhjetor të vitit 2011, Gjykatat e Kosovës arritën të dërgoj në përbarim 25.275 raste të vjetra (ose pothuajse 25% e lëndëve të grumbulluara) në vitin 2014. Shumica e këtyre rasteve kanë kërkuar zbatimin e vendimeve në lidhje me pagesën e faturave të shërbimeve komunale. KGJK-ja planifikon të reduktojë edhe më tej lëndët e grumbulluara deri në vitin 2016, sidomos me anë të zgjidhjes alternative të kontesteve.

**71) Të garantojë se shkëmbimi i informatave në fushën e zbatimit të ligjit, i kryer nëpërmes kanaleve përkatëse, funksionon në relacion me të gjitha Shtetet Anëtare: PLOTËSUAR**

Bashkëpunimi në fushën e zbatimit të ligjit zhvillohet qoftë në baza bilaterale, që lehtësohet nga Njësia për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zbatimin e Ligjit (ILECU) e policisë, apo në lidhje me Evropolin nëpërmjet EULEX-it, apo në lidhje me Interpolin nëpërmjet pikës së kontaktit të vendosur në Misionin e Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Këto dy të fundit lehtësojnë edhe shkëmbimin e informacioneve në fushën e zbatimit të ligjit me Serbinë.

**72) Të shtojë bashkëpunimin operacional me autoritetet e zbatimit të ligjit të Shteteve Anëtare dhe vendeve të treta, me theks të veçantë përmes realizimit të hetimeve dhe operacioneve të përbashkëta: PLOTËSUAR**

Në vitin 2015, Kosova ka kryer hetime të përbashkëta me Austrinë, Republikën Çeke, Francën, Gjermaninë, Hungarinë, Sllovakinë dhe Zvicrën.

**73) Të përmirësojë kapacitetet hetuese të udhëhequra nga inteligjenca të autoriteteve për zbatimin e ligjit për të hetuar krime të rënda ndërkufitare: PLOTËSUAR**

Kosova, në vitin 2015 ka forcuar në mënyrë të konsiderueshme policimin e udhëhequr nga inteligjenca, e cila duhet të jetë e qëndrueshme. Policia e Kosovës ka qasje në një gamë bazash të të dhënave të nevojshme për punën e saj dhe shkëmben informata me partnerët rajonalë dhe të BE-së siç është përcaktuar më sipër.

**74) Të hartojë dhe komunikojë me kohë statistika të hollësishme lidhur me shkëmbimin e informatave në fushën e zbatimit të ligjit, hetimeve dhe operacioneve të përbashkëta tek autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare, Komisionit Evropian, dhe EULEX-it: PLOTËSUAR**

Kosova vazhdon të ndajë statistikat me Shtetet Anëtare, Komisionin dhe EULEX-in në lidhje me bashkëpunimin në fushën e zbatimit të ligjit dhe hetimet e përbashkëta.

**75) Të shqyrtojë mundësitë për bashkëpunim me EUROPOL-in: PLOTËSUAR**

Marrëdhëniet me Europol-in nëpërmjet EULEX-it janë përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme dhe në këtë mënyrë edhe bashkëpunimi me Interpol-in nëpërmjet pikës së kontaktit me UNMIK-un. Në gusht të vitit 2015, Kosova ka dorëzuar aplikacionin për t'iu bashkangjitur Interpol-it.

Policia e Kosovës ka qasje në seminarët e organizuara nga Kolegji i Policisë Evropiane (CEPOL).

**76) Të shqyrtojë mundësitë e bashkëpunimit me EMCDDA: PLOTËSUAR**

EMCDDA ka zbatuar një projekt koordinues teknik me Kosovën që nga viti 2009.

**77) Të shqyrtojë mundësitë e bashkëpunimit me iniciativat rajonale për bashkëpunim në fushën e zbatimit të ligjit: PLOTËSUAR**

Kosova iu është afruar organeve rajonale të zbatimit të ligjit, siç është SELEC, megjithatë bashkëpunimi i ngushtë është i pamundur për momentin.

## **Bashkëpunimi gjyqësor për çështje penale**

Kosova ka plotësuar **të gjitha shtatë kërkesat** në fushën e bashkëpunimit gjyqësor për çështjet penale.

### **78) Të zbatojë legjislacionin ekzistues për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje penale: PLOTËSUAR**

Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet penale është i udhëzuar, nga ana e Kosovës, me ligjin e Kosovës për bashkëpunim juridik ndërkombëtar. Ky ligj mbetet themeli i kornizës ligjore të Kosovës për bashkëpunim.

Autoriteti i duhur është plotësuar me personel të mjaftueshëm për trajtimin e kërkesave hyrëse dhe dalje për ndihmë reciproke juridike.

### **79) Të zbatojë marrëveshjet ekzistuese për bashkëpunim juridik në çështje penale dhe ku është e mundshme të nënshkruaj marrëveshje të reja: PLOTËSUAR**

Kosova ka lidhur dy marrëveshjeve të ndihmës reciproke juridike me Belgjikën, Kroacinë, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Gjermaninë, Italinë, Zvicrën dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Bashkëpunimi me Serbinë, nëpërmjet Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian (PSBE), është përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme.

### **80) Të miratojë dhe zbatojë masa që kanë për qëllim përmirësimin e efikasitetit, efektivitetit dhe pavarësisë së bashkëpunimit gjyqësor në çështje penale me Shtetet Anëtare dhe vendet e treta: PLOTËSUAR**

Shih vlerësimin në kërkesën 79.

### **81) Të zbatojë marrëveshjen teknike me EULEX-in për ndihmën reciproke juridike: PLOTËSUAR**

Kjo është zbatuar plotësisht.

### **82) Të sigurojë se bashkëpunimi gjyqësor për çështje penale, i realizuar nëpërmes kanaleve përkatëse, funksionon në lidhje me të gjitha Shtetet Anëtare: PLOTËSUAR**

Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet penale funksionon me Shtetet Anëtare të BE-së, qoftë nëpërmjet marrëveshjeve bilaterale apo PSBE-së.

### **83) Të hartojë dhe komunikojë me kohë statistika të hollësishme për rastet e bashkëpunimit juridik në çështje penale tek autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare, Komisionit Evropian, dhe EULEX-it: PLOTËSUAR**

Kosova vazhdon të shkëmbejë statistika mbi kërkesat për ndihmë juridike reciproke me Shtetet Anëtare, Komisionin dhe EULEX-in.

### **84) Të shqyrtojë mundësitë e bashkëpunimit me EUROJUST: PLOTËSUAR**

Kosova ka hulumtuar mundësitë e bashkëpunimit me Eurojust.

## **Mbrojtja e të dhënave**

Kosova ka plotësuar **të gjitha tri kërkesat** në fushën e mbrojtjes së të dhënave.

**85) Të harmonizojë me *acquis* të BE-së dhe të zbatojë legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale: PLOTËSUAR**

Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale është në harmoni me *acquis* të BE-së, edhe pse ndryshimet e ardhshme në kornizën e BE-së për mbrojtjen e të dhënave duhet të integrohen në strukturën ligjore të Kosovës. Agjencia për mbrojtjen e të dhënave ka miratuar legjislacionin sekondar mbi sigurinë e të dhënave.

**86) Të garantojë pavarësinë dhe të fuqizojë kapacitetet e autoritetit për mbrojtjen e të dhënave: PLOTËSUAR**

Agjencia për mbrojtjen e të dhënave tani konsultohet në mënyrë sistematike mbi projektligjet e dërguara në Kuvend—kompetencë që ka përdorur për të ndikuar në përmbajtjen e disa pjesëve të draft legjislacionit.

**87) Të mbaj programe trajnuese lidhur me kundër-korrupsionin dhe të vendos një kod të etikës për zyrtarët e autoritetit për mbrojtjen e të dhënave personale: PLOTËSUAR**

Agjencia gjithashtu ka organizuar një sërë aktivitete vetëdijësuese dhe tani janë caktuar zyrtarët për mbrojtjen e të dhënave në nivel lokal. Buxheti i Agjencisë duhet të ruhet.

**BLLOKU 4: TË DREJTAT THEMELORE LIDHUR ME LIRINË E LËVIZJES**

Kosova ka plotësuar shtatë nga tetë kërkesat në fushën e të drejtave themelore lidhur me lirinë e lëvizjes

**LIRIA E LËVIZJES**

**88) Të sigurojë që liria e lëvizjes së qytetarëve të Kosovës nuk i nënshtrohet kufizimeve të paarsyeshme, duke përfshirë edhe masat e natyrës diskriminuese, të bazuar në çfarëdo baze si gjinia, raca, ngjyra, etnia ose origjina sociale, tiparet gjenetike, gjuha, besimi ose religjioni, mendimi politik ose ndonjë mendim tjetër, përkatësia e një grupi minoritar, prona, lindja, aftësitë e kufizuara, mosha ose orientimi seksual: PJESËRISHT E PLOTËSUAR**

Korniza e të drejtave themelore mbetet e qëndrueshme dhe është fuqizuar me miratimin e ligjit për mbrojtje nga diskriminimi, ligjit për barazinë gjinore dhe ligjit për avokatin e popullit në maj të vitit 2015. Ligjet janë miratuar si një pako e vetme legjislative (Pakoja e Ligjeve për të Drejtat e Njeriut) dhe ka hyrë në fuqi në qershor të vitit 2015.

Zbatimi i ligjit të avokatit të popullit duhet të rrisë në veçanti kapacitetet dhe burimet e institucionit për tu marrë me mandatin e tij të zgjeruar. Si organi kryesor i vendit për trajtim të barabartë dhe mekanizëm kombëtar për parandalim, ai ka nevojë për më shumë personel, objekte të duhura dhe buxhet të duhur për përmbushjen e rolit të tij të ri. Masat fillestare të ndërmarra nga qeveria janë në kundërshtim me frymën e ligjit të ri. Qeveria duhet të ndajë objekte të duhura dhe të sigurojë pavarësinë e plotë buxhetore të avokatit të popullit.

Zyrat rajonale të avokatëve të popullit sigurojnë që qytetarët të kenë qasje në informacione mbi mandatin dhe detyrat e tij.

Për të qenë në pajtueshmëri të plotë me kërkesat në fushën e të drejtave themelore të lidhura me lirinë e lëvizjes, Kosova duhet të sigurojë hapësira të duhura për avokatin e popullit dhe të sigurojë pavarësinë e plotë buxhetore të tij.

### **Kushtet dhe procedurat për lëshimin e dokumenteve identifikuese**

- 89) Të sigurojë se të gjithë qytetarët e Kosovës, përfshirë femrat, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, personat që i përkasin një minoriteti dhe individëve tjerë të cenueshëm kanë qasje të plotë dhe efektive në dokumentet personale të udhëtimit dhe identifikuese, përfshirë regjistrimin civil: PLOTËSUAR**

Regjistrimi civil për gjithë qytetarët e Kosovës, duke përfshirë femrat, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara dhe personat që i përkasin një minoriteti, është përmirësuar në masë të madhe gjatë rrjedhës së dialogut për viza dhe tani është i kënaqshëm.

- 90) Të sigurojë qasje të plotë dhe efektive në dokumentet personale të udhëtimit dhe dokumente identifikuese për personat e zhvendosur, refugjatët dhe të kthyerit: PLOTËSUAR**

Regjistrimi civil i refugjatëve dhe të kthyerve është plotësisht i kënaqshëm.

### **Të drejtat e njeriut si dhe respektimi dhe mbrojtja e minoriteteve**

- 91) Të sigurojë se të gjitha dispozitat vendore për të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e minoriteteve respektohen plotësisht: PLOTËSUAR**

Pakoja për të drejtat e njeriut ka hyrë në fuqi në qershor të vitit 2015. Ju lutem shihni kërkesën 89.

- 92) Të miratojë dhe zbatojë legjislacioni që përcakton mbrojtje efektive kundër diskriminimit: PLOTËSUAR**

Ligji për mbrojtje nga diskriminimi përfshinë dispozitat për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit, promovimin e barazisë efektive dhe funksionalizimin e parimit të trajtimit të barabartë të të gjithë personave para ligjit. Ligji për barazi gjinore siguron respektim të plotë të të drejtave të grave në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ligji i ri për avokatin e popullit ka përmirësuar legjislacionin mbi institucionin e avokatit të popullit, duke zgjeruar mandatin e tij dhe duke i fuqizuar dispozitat mbi pavarësinë dhe paanshmërinë e tij. Për zbatimin e këtyre ligjeve kërkohet miratimi i tetë akteve nënligjore deri në fund të vitit 2015.

- 93) Të sigurojë se legjislacioni përkatës për përcaktimin e kushteve dhe rrethanave të marrjes së nënshtetësisë së Kosovës zbatohet në mënyrë adekuate: PLOTËSUAR**

Marrja e nënshtetësisë së Kosovës është e rregulluar në mënyrë të duhur me ligjin e ndryshuar mbi shtetësinë i cili është miratuar në vitin 2013.

- 94) Të sigurojë që incidentet e motivuara etnikisht të kryera në fushën e lëvizjes së lirë, duke përfshirë ato incidente që shënjestrojnë personat me përkatësi minoritare, do të hetohen plotësisht: PLOTËSUAR**

Zbatimi strikt i nenit 147 të kodit penal nuk do të mbulojë të gjitha incidentet me motive etnike, meqë ky nen nuk mbulon synimet e krimit. Përdorimi ekskluziv i këtij neni do të thotë se regjistrimi i incidenteve mund të mos marrë parasysh motivimin e tyre të mundshëm etnik. Ky boshllëk do të mund të adresohet përmes zbatimit të nenit 74.2.12 të kodit penal, i cili merr parasysh nëse krimi është i motivuar etnikisht.

Në vitin 2014, Policia e Kosovës ka regjistruar 19 raste me motive të mundshme etnike. Në tremujorin e fundit të vitit 2014 janë raportuar 26 raste me motive të mundshme etnike. Mekanizmi i përcjelljes është funksional që nga viti 2014. Megjithatë, numri i rasteve të krimeve me motive të mundshme etnike mbetet i paqartë, pasi që statistikat nuk mblidhen në një mënyrë të harmonizuar nga policia e Kosovës.

## 95) Të miratojë dhe zbatojë masat që përmirësojnë integrimin efektiv të personave që i përkasin minoritetit Serb, Rom, Ashkali, Egjiptas, Boshnjak, Turk, dhe Goran të Kosovës: **PLOTËSUAR**

Qeveria po ashtu ka vazhduar zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit për integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas. Financim i mëtjshëm është alokuar dhe shpenzuar në nivel lokal, për të përfituar ndërmarrje të ndryshme që kanë synuar minoritetet Rom, Ashkali dhe Egjiptas.

Tani kanë hyre në funksion rregulloret që e bëjnë të mundur shmangien e mbivendosjeve ndërmjet mandateve të këshillave komunalë për sigurinë e komunitetit dhe kuvendeve komunale. Manuali për këshillat është publikuar në janar të vitit 2015.

### **3. VLERËSIMI I NDIKIMEVE MIGRATORE DHE TË SIGURISË NGA LIBERALIZIMI I VIZAVE**

#### **3.1. Siguria: Gjendja aktuale dhe ndikimet e mundshme nga liberalizimi i vizave me Kosovën**

Kosova vazhdon të përballet me sfidat e parandalimit dhe luftimit efektiv të krimit të organizuar dhe korrupsionit. Rrjetet kriminale që veprojnë në Kosovë vazhdojnë të paraqesin një kërcënim të konsiderueshëm për sigurinë e brendshme të Bashkimit Evropian.

##### **3.1.1. Gjendja aktuale**

###### **Shtrirja gjeografike**

Grupet shqip-folëse të krimit të organizuar tashmë janë të pranishme dhe të angazhuara në aktivitete kriminale në 19 Shtetet Anëtare të BE-së dhe në Shtetet Anëtare të Zonës Shengen. Këto grupe mund të përbëhen nga shtetas jo vetëm të Kosovës, por edhe të Shqipërisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Serbisë. Disa nga ta kanë gjithashtu shtetësi të vendeve të BE-së. Ata shpesh kanë interesa në rajonin e tyre të origjinës dhe mbajnë kontakte me komunitetet e diasporës.

Disa anëtarë të këtyre grupeve kthehen në Kosovë për t'iu shmangur ndjekjen penale jashtë vendit, ndërsa të tjerët njihen për drejtimin e veprimtarive nga Kosova në BE.

###### **Sektorët kriminale**

Këto grupe janë aktive në një gamë të konsiderueshme të fushave të krimit, dhe ka indikacione se ato përbëjnë një kërcënim të konsiderueshëm në sektorët e mëposhtëm:

- **Trafikimi i narkotikëve**, siç janë prodhimi dhe trafikimi i kanabisit dhe trafikimi i heroinës dhe kokainës;
- Disa grupe mund të jenë bërë aktive **në lehtësimin e migracionit të parregullt të qytetarëve të Kosovës** dhe në një masë më të vogël, të shtetasve të vendeve të treta për në BE;
- **Korrupsioni, pastrimi i parave** dhe mashtrimi, duke përfshirë akcizën dhe përfitimi nga mashtrimi;
- **Trafikimi me qenie njerëzore**, sidomos për shfrytëzim seksual;
- **Trafikimi ilegal i armëve të vogla** dhe të lehta.

Kontrabanda me mallra të falsifikuara i ndërmarrë nga disa prej këtyre grupeve mbetet një problem që ndikon më tepër në Ballkanin Perëndimor sesa në BE-në.

### **Trafikimi i narkotikëve**

Në tregtinë e heroinës dhe kokainës e cila prek BE-në, rruga e Ballkanit Perëndimor, përfshirë edhe Kosovën, vazhdon të luaj një rol të rëndësishëm. Kosova ende vazhdon të përdoret si një vend i magazinimit dhe si qendër shpërndarëse e heroinës së trafikuar.

Pavarësisht përpjekjeve të rëndësishme të zbatimit të ligjit gjatë vitit 2014-2015 për çrrënjosjen e plantacioneve të kanabisit, vazhdon prodhimi në një shkallë më të vogël në Kosovë. Kanabisi prodhohet për tregun rajonal, ndërsa konfiskimet e sasive të mëdha gjatë vitit 2014 tregojnë se shumica e kanabisit trafikohet nga Shqipëria përmes Kosovës tek Shtetet Anëtare të BE-së.

Kanabisi i rritur në Shqipëri dhe Kosovë shpërndahet në disa Shtete Anëtare të BE-së dhe në Shtete Anëtare të Zonës Shengen. Gjithashtu është vërejtur një konkurrencë në tregtinë e kanabisit mes grupeve të krimit të organizuar të cilat janë aktive në BE.

Kosova është më pak e ekspozuar ndaj trafikimit të drogave sintetike, megjithëse ka prekursorë që janë zbuluar nëpër kamionë.

Shumica e këtyre grupeve janë gjithashtu të përfshira në krime të rënda përveç atij të trafikimit me narkotik.

### **Lehtësimi i migracionit të parregullt**

Disa grupe kriminale të përfshira në lehtësimin e migracionit të parregullt janë përqendruar veçanërisht në qytetarët e Kosovës. Disa nga lehtësuesit janë anëtarë të komunitetit të diasporës; të tjerët janë vetë ish-emigrantët.

Këto grupe shpesh punësojnë shtetas të BE-së si shoferë ose kontrabandistë lokal dhe bashkëpunojnë me falsifikatorët e dokumenteve të cilët lehtësojnë shërbimet e tyre. Në të kaluarën, janë përdorur më shpesh makinat private; por kriza e jashtëzakonshme e emigrimit nga Kosova gjatë periudhës shtator 2014 - mars 2015 ka shfaqur një besim të shtuar në kompanitë e autobusëve. Zyrtarët e korruptuar kufitar njihen për mit-marrje për të lehtësuar lëvizjen e pasagjerëve.

Leje-qëndrimet e falsifikuara janë përdorur në disa Shtete Anëtare të BE-së dhe në Shtete Anëtare të Zonës Shengen për të rregulluar qëndrimin e emigrantëve në zonën Shengen. Disa agjencione turistike kanë ofruar pako me dokumente të falsifikuara për qytetarët e Kosovës të cilët kërkonin që të aplikonin për viza Shengen. Një tjetër metodë e mashtrimit me dokumente përfshin aplikimet për pasaporta biometrike serbe, duke anashkaluar kërkesën e vendbanimit që është e nevojshme në Serbi për t'u kualifikuar për dokumente të tilla. Nganjëherë është përdorur ryshfeti për të lehtësuar këtë proces.

Dokumente të falsifikuara janë përdorur shpesh nga këto grupe për të lehtësuar migracionin e parregullt.



## **Korrupsioni, pastrimi i parave dhe mashtrimi**

Kosova ka vendosur një kornizë ligjore dhe institucionale të kundër korrupsionit. Megjithatë, zbatimi i saj mbetet një sfidë. Indeksi<sup>15</sup> i Perceptimit të Korrupsionit për vitin 2014 nga Organizata Transparency International ka renditur Kosovën në vendin e 110 nga 174 shtete të anketuara në nivel global, në të njëjtin nivel me Shqipërinë. Kosova (dhe Shqipëria) kishin renditjen më të keqe në Ballkanin Perëndimor për të dytin vit radhazi.

Pavarësisht progresit të kohëve të fundit në modernizimin e kornizës legislative dhe zbatimit të një sistemi të centralizuar të prokurimit publik, prokurimi publik mbetet një burim kryesor i korrupsionit në Kosovë.

Trafikimi me medikamente dhe cigare të falsifikuara mbetet një problem mesatar në Kosovë. Kontrabanda me karburante, veçanërisht në veri të Kosovës, mbetet një problem.

Të ardhurat e paligjshme nga krimet e rënda po investohen gjithnjë e më shumë në bizneset e ligjshme në Shtetet Anëtare të BE-së dhe në Shtetet Anëtare të Zonës Shengen. Forma më e zakonshme e pastrimit të parave përfshin investimet në pasuri të patundshme, përdorimin e paraqsave të taksave dhe investimi në biznese, siç janë restorantet, baret, kazinot, kompanitë e udhëtimit dhe kompanitë ndërtimore në Ballkanin Perëndimor dhe në disa Shtete Anëtare të BE-së.

## **Trafikimi me qenie njerëzore**

Kosova vazhdon të ndikohet nga trafikimi me qenie njerëzore. Më parë, qytetarët e vendeve tjera janë trafikuar në Kosovë për shfrytëzim seksual; sot, qytetarët e Kosovës janë duke u bërë gjithnjë e më shumë viktima të këtij krimi të rëndë.

Punëtorë nga Kosova janë trafikuar gjithashtu në Shtetet Anëtare të BE-së për shfrytëzim të punës, duke përdorur dokumente të falsifikuara.

## **Trafikimi i armëve të vogla dhe të lehta**

Armët e lehta të riaktivizuara ndonjëherë konvertohen në Kosovë para trafikimit të tyre në BE. Sidoqoftë, gjurmimi i armëve dhe kontrollet e zbatimit të ligjit për armë janë përmirësuar në Kosovë.

## **Metodat penale**

Disa grupe njihen gjithashtu për ngritjen e bizneseve legale, të tilla si dyqane, restorante, kazino dhe punëtori, në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor për të lehtësuar ndërmarrjet e tyre kriminale.

Korrupsioni dhe ryshfeti ndaj zyrtarëve publikë në Ballkanin Perëndimor dhe nganjëherë edhe në BE përdoret kur të nevojitet lehtësimi i ndërmarrjeve kriminale.

Disa nga këto grupe kanë themeluar gjithashtu partneritete kriminale në Ballkanin Perëndimor dhe në Shtetet Anëtare të BE-së. Në BE, partneritete të tilla janë vërejtur me grupet italiane të krimit të organizuar dhe grupet nigeriane dhe marokene që janë aktive në Shtetet Anëtare. Në Ballkanin Perëndimor, grupet me bazë në Kosovë kanë krijuar partneritete me grupet e krimit të organizuar nga Turqia, Rumania dhe Bullgaria.

Dhuna nganjëherë përdoret për ta mbajtur disiplinën; disa nga anëtarë të këtyre grupeve posedojnë armë zjarri. Shumë nga këto grupe qëndrojnë mirë financiarisht dhe janë të aftë që të bëjnë pastrimin e të ardhurave nga krimi në sektorë tjerë apo në biznese legale. Grupe të cilat janë më të varfra përdorin ndonjëherë zhvatjen dhe fajdën në mënyrë që t'i rrisin fitimet.

<sup>15</sup> <https://www.transparency.org/cpi2014/results>

### **3.1.2. Ndikimet e mundshme nga liberalizimi i vizave me Kosovën**

Grupet shqip-folëse të krimit të organizuar tashmë janë në gjendje që të menaxhojnë lëvizjet ndërmjet BE-së dhe Kosovës, dhe shpesh janë të lidhura me grupet e krimit të organizuar në diasporë. Prandaj është e paqartë nëse liberalizimi i vizave do të ketë një ndikim të fortë në fushëveprimin e operacioneve dhe në *modi operandi* të shumë grupeve shqipfolëse të krimit të organizuar.

### **3.1.3. Rekomandimet**

Për t'i adresuar këto kërcënime dhe për të qenë në përputhje të plotë me kërkesat e udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave në fushën e luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit, Kosova duhet të veprojë si në vijim:

- Të transferoj një numër të mjaftueshëm të gjykatësve, me personelin e duhur mbështetës, në departamentet e krimeve të rënda në të gjitha gjykatat në Kosovë;
- Të krijojë një regjistër të hetimeve, aktgjykimeve finale në rastet e rënda të krimit të organizuar dhe korrupsionit, përkatësisht përmes dhënies së mandatit dhe burimeve për rastet e rënda të krimit të organizuar dhe korrupsionit tek koordinatori qendror për udhëheqjen e ekipeve multi-disiplinore të hetimeve financiare dhe për monitorimin e përcjelljes gjyqësore të rasteve të tilla;
- Të sigurojë pavarësinë funksionale të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik. Duhet të zbatohen plane strikte të integritetit për të mbrojtur pavarësinë e këtij organi dhe të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.

## **3.2. Migrimi: gjendja aktuale dhe ndikimet e mundshme nga liberalizimi i vizave me Kosovën**

### **3.2.1. Gjendja aktuale**

Shifrat e migrimit të parregullt nga Kosova drejt BE-së kanë lëvizur gjatë viteve të fundit dhe kanë ndryshuar anëmbanë Shteteve Anëtare. Përderisa në fund të vitit 2014 dhe në fillim të vitit 2015 pamë një rritje të paprecedentë në migrimin e parregullt dhe një rritje korresponduese në kërkesat për azil nga qytetarët e Kosovës në BE, këto shifra kanë rënë nga maji i vitit 2015.

### **Kriza e jashtëzakonshme e migrimit nga Kosova, shtator 2014- prill 2015**

Kosova ka qenë dëshmitare e **një krize të jashtëzakonshme të migrimit** gjatë periudhës shtator 2014 - mars 2015, duke përfshirë lëvizjen në shkallë të gjerë të qytetarëve të saj, nëpërmjet Serbisë dhe Hungarisë, kryesisht në Gjermani dhe Austri. Sipas Eurostat, 87,495 qytetarë të Kosovës kërkuan azil në BE dhe në Shtetet Anëtare të Zonës Shengen gjatë periudhës shtator 2014 - mars 2015.

Marrëveshja e arritur në korrik të vitit 2011 për lirinë e lëvizjes në mes të Beogradit dhe Prishtinës ka mundësuar, duke filluar nga dhjetori i vitit 2011, kalimin e kufirit/kufirit administrativ Kosovë-Serbi me letërnjoftim dhe me formular për hyrje/dalje. Që nga nëntori i vitit 2014, janë hapur pika të reja të kalimit kufitar të Serbisë përgjatë kufijve të Serbisë me fqinjët e saj duke lehtësuar lëvizjen.

Vendimet nga gjykatat administrative Gjermane për të ndalur transferimet nga Dublini në Hungari, nga mesi i vitit 2014, mund të kenë vepruar si një faktor shtytës. Vendimi i Francës, në tetor të vitit 2014, për të hequr Kosovën nga lista e vendeve të sigurta gjithashtu mund të ketë vepruar si një tjetër faktor shtytës. Kosova ka një komunitet të madh të diasporës,


kryesisht në Gjermani, Zvicër dhe Suedi, që e bën relativisht të lehtë për emigrantët të gjejnë një rrjet mbështetës në vendet e destinacionit.

Kjo krizë migrimi në mënyrë tipike ka përfshirë të rinjtë shqiptarë dhe disa nga ata kanë udhëtuar me familjet e tyre. Në të kaluarën, pjesëtarët e komuniteteve pakicë kanë qenë më të prirur për të migruar.

Udhëtimi i emigrantëve nga Kosova në Serbi u lehtësua nga kompanitë e autobusëve. Këto kompani kanë përdorur mediat lokale për të reklamuar shërbimet e tyre. Kur këta autobusë kalonin pikën kufitare/kufirin administrativ me Serbinë, rojet kufitare do të kontrollonin identitetin e udhëtarëve, por jo kushtet tjera që dalin nga Kodi i Shengenit për Kufijtë. FRONTEX ka vlerësuar se rojet kufitare të Kosovës bindën më shumë se 5.000 udhëtarë të mos hyjnë në Serbi gjatë vitit 2014.


Qytetarët e Kosovës pastaj kanë vazhduar udhëtimin nga Beogradi në Suboticë dhe në mënyrë tipike kanë kaluar kufirin e gjelbër Serbi-Hungari. Gjatë kalimit në mënyrë të parregullt në zonën Shengen, emigrantët shpesh kapeshin nga policia hungareze ku edhe dorëzonin kërkesën e tyre për azil. Një qytetar i Kosovës ka qëndruar në Hungari mesatarisht 2-5 ditë para se të arratisej, për ta vazhduar udhëtimin e tyre drejt Gjermanisë, Austrisë dhe Shteteve tjera Anëtare.

*Figura 3.2.1. Kërkesat për azil të parashtruara nga qytetarët e Kosovës në Shtetet Anëtare të BE-së dhe në Shtetet Anëtare të Zonës Shengen, 2014-2015*



Burimi: Të dhënat nga Analiza e Riskut të Rrjetit FRONTEX, 2015

Figura 3.2.2. Kthimet efektive në Kosovë nga Shtetet Anëtare dhe Shtetet Anëtare të Zonës Shengen



Burimi: Të dhënat nga Analiza e Riskut të Rrjetit FRONTEX, 2015

### **Hapat e Kosovës për të frenuar krizën e jashtëzakonshme të migrimit, shkurt-prill 2015**

Me ndërmjetësimin e BE-së dhe në bashkëpunim të ngushtë me Serbinë, Kosova ndërmori një numër hapash të menjëhershëm operativ që kontribuan në uljen e fluksit të migrimit që nga marsi i vitit 2015. Që nga maji i vitit 2015, numri i kërkesave për azil ka rënë nga 2,850 aplikime në maj në 1,155 në shtator të vitit 2015.

Ndër të tjerash, Kosova ndërmori hapat në vijim për të zvogëluar fluksin e migrimit:

- 1) **Organizimin e një fushate të fokusuar informuese**, përfshirë edhe në pikë-kalimet kufitare/kufirin administrativ me Serbinë. Kjo përfshinte shpërndarjen e fletushkave në gjuhët zyrtare të Kosovës si dhe politikanët e lartë, përfshirë presidenten për informimin e qytetarëve përmes mediave publike mbi pasojat e hyrjes së parregullt në zonën Shengen, përfshirë qëndrimin më tepër se që është e lejuar dhe ndalimin e hyrjes në këtë zonë për 5 vite;
- 2) **Kontrollet e shtuara kufitare**, përfshirë kontrollet e linjës së parë dhe të dytë dhe mbikëqyrjen përgjatë pikë-kalimeve kufitare me Serbinë, duke kontrolluar në tërësi letërnjoftimet, licencat administrative të autobusëve dhe shpjegimin e kushteve për hyrje në zonën Shengen. Kosovës iu është përkujtuar se praktika e saj e "bindjes" së qytetarëve për braktisjen e Kosovës duhet të jetë në pajtim me të drejtat themelore të udhëtarëve.
- 3) **Shtimi i hetimeve ndaj kompanive të udhëtimit** që kanë lehtësuar transferet në Serbi, me fokus të veçantë në kompanitë e sapo-themeluara. Kjo përfshinte tërheqjen e licencave të kompanive të autobusëve që nuk i kanë plotësuar kushtet e transportit dhe legjislacionin e brendshëm;

- 4) **Sigurimi i pritjes së të kthyerve** në Kosovë nga të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së, përmes gjetjes së aranzhmaneve praktike për identifikimin dhe regjistrimin e tyre në bazën e të dhënave të riintegritimit duke siguruar kështu informacion të plotë mbi përfitimet për të cilat ata mund të kualifikohen dhe sigurimin e transferimit të tyre nga kufiri tek komunitat ku banojnë;
- 5) **Ndërmarrja e hapave për përmirësimin e shkëmbimit të informacionit**, nëpërmjet EULEX-it, me Europolin mbi aspektet kriminale të migrimit të parregullt, me FRONTEX-it për analizat e lidhura me rrezikun e migrimit, dhe me EASO mbi trendët e azilit.

### **3.2.2. Ndikimet e mundshme nga liberalizimi i vizave me Kosovën**

Që nga maji i vitit 2015, autoritetet e Kosovës kanë futur disa masa lehtësuese që kanë kontribuar në uljen e flukseve të migrimit të parregullt dhe duke i informuar qytetarët e Kosovës mbi të drejtat dhe obligimet e tyre për të hyrë në Zonën Shengen.

Masat e ndërmarra nga autoritetet e Kosovës për të parandaluar një krizë të re të migrimit duhet të mbesin në fuqi.

### **3.2.3. Rekomandimet**

Për të parandaluar një krizë të ngjashme migrimi në të ardhmen, Kosova inkurajohet që të vendosë instrumentet e mësipërme nëse shtrohet nevoja. Kosova duhet të vazhdojë të organizojë fushata të fokusuara informuese me qëllim të sqarimit të të drejtave dhe detyrimeve të lëvizjes pa viza në zonën Shengen dhe rregullat që e rregullojnë qasjen në tregun e punës së BE-së.

Kosova është e inkurajuar gjithashtu që të merr në konsideratë rekomandimin e mëposhtëm të përfshirë në raportin e tretë të Komisionit për të zbutur ndikimin e mundshëm të migrimit në BE nga heqja e regjimit të vizave:

- Për të qenë plotësisht në pajtim me kërkesat në fushën e riintegritimit, Fondi për Ri-integrim duhet të disbursohet plotësisht, me fokus të veçantë në ofrimin e asistencës në punësim, krijim të bizneseve të vogla, trajnim profesional dhe trajnim gjuhësor për fëmijët.

### **3.3. Treguesit e performancës së migrimit**

Komisioni ka vazhduar të monitorojë pesë treguesit e performancës së përcaktuar në udhërrëfyesin e vizave.<sup>16</sup> **Një rënie e konsiderueshme e këtyre treguesve të performancës** gjatë rrjedhës së dialogut të vizave, do të përdoret si referencë indikative në vlerësimet e Komisionit për ndikimin e pritshëm të migrimit nga liberalizmi i regjimit të vizave për Kosovën.

Vitin e kaluar janë vërejtur trendët si në vijim:

- shkalla e refuzimit të vizave për qytetarët e Kosovës, e llogaritur si mesatare për 13 Shtetet Anëtare të BE-së dhe Shtetet Anëtare të Zonës Shengen **u rrit në 1%**, nga 20.1% në 21.1% në mes të periudhës 2013 dhe 2014 (shih figurën 2.1);

<sup>16</sup> Ato janë si në vijim: shkalla e refuzimit të vizave për aplikuesit nga Kosova; shkalla e refuzimit të hyrjes në zonën Shengen për qytetarët e Kosovës; numri i qytetarëve të Kosovës me qëndrim të paligjshëm në territorin e një prej Shteteve Anëtare; numri i përgjithshëm i kërkesave për azil nga qytetarët e Kosovës; dhe numri i aplikacioneve të refuzuara për ripranim, dorëzuar nga një Shtet Anëtar në Kosovë për qytetarët e Kosovës.

- numri i qytetarëve të Kosovës të cilëve iu është refuzuar hyrja në kufijtë e jashtëm të zonës Shengen ka **rënë për 11%** nga 1,465 në 1,315 mes viteve 2013 dhe 2014. Kroacia mbetet më e prekura me gjithsej 560 refuzime të hyrjes (shih figurën 2.2);
- numri i qytetarëve të Kosovës që janë kapur duke qëndruar në mënyrë të paligjshme në Shtetet Anëtare të BE-së apo Shtetet e Zonës Shengen është **rritur për 38%**, nga 9,785 në 13,545 mes viteve 2013 dhe 2014. Me 4,110 zbulime të qëndrimeve ilegale, Gjermania mbetet Shteti Anëtar më i prekur nga kjo shifër (shih figurën 2.3 );
- numri i kërkesave për azil, të paraqitura nga qytetarët e Kosovës në Shtetet Anëtare të BE-së apo në Shtetet e Zonës Shengen është **rritur për 82%** nga 21,175 në 38,450 mes viteve 2013 dhe 2014. Si rezultat i fluksit të jashtëzakonshëm të migrimit nga Kosova në fund të vitit 2014 dhe në fillim të vitit 2015, numri i përgjithshëm i aplikimeve për azil të parashtruara nga qytetarët e Kosovës ka arritur **shifrën prej 67,975** në nëntë muajt e parë të vitit 2015. Shumica e këtyre kërkesave janë paraqitur nga janari deri në prill të vitit 2015 (57,460), ndërsa nga muaji maj deri në shtator 2015, numrat kanë rënë në (10355). Gjermania mbetet Shteti Anëtar më i prekur, me 34,195 kërkesa në tre tremujorët e parë të vitit 2015, (shih figurën 2.4). Shkalla e njohjes në nivel të parë u rrit nga 4.5% në 7.3% në mes të viteve 2013 dhe 2014 (shih figurën 2.5). Megjithatë, kjo dukshëm u zvogëlua në 1.9% në gjysmën e parë të vitit 2015 dhe në 2.0% në tre tremujorët e parë të vitit 2015. Kjo normë mund të zvogëlohet më tej në të ardhmen në qoftë se ligjvënësit miratojnë propozimin e Komisionit për të vendosur Kosovën në një listë të përbashkët të BE-së së vendeve të sigurta të origjinës;<sup>17</sup>
- Numri i aplikimeve të refuzuara për ripranim nga ana e Kosovës **ka rënë me 49%**, nga 404 në 208 dhe më tej në 188 në 10 muajt e parë të vitit 2015. Në vitin 2015, Kosova ka refuzuar vetëm 188 prej 10,144 kërkesave për ripranim, apo më pak se 2% të parashtruara nga Shtetet Anëtare të BE-së dhe Shtetet Anëtare të Zonës Shengenit, duke treguar se ripranimi funksionon në praktikë.

### **Konkluzione**

Një përmbledhje e treguesve të performancës së migrimit të cilën Komisioni e përdor për të monitoruar ndikimin e mundshëm të migrimit për liberalizim të vizave, sugjeron si më poshtë:

- **Siç u kërkua nga udhërrëfyesi për liberalizim të vizave, numri i refuzimeve të hyrjes dhe numri i aplikacioneve të refuzuara për ripranim ka rënë gjatë periudhës raportuese;**
- **Megjithatë, numri i kërkesave për azil u rrit ndjeshëm si rezultat i krizës së jashtëzakonshme të migrimit në fund të vitit 2014 dhe në fillim të vitit 2015;**
- **Numri i qytetarëve të Kosovës që janë kapur duke qëndruar në mënyrë të jashtëligjshme në zonën Shengen si dhe shkalla e refuzimit të vizave gjithashtu është rritur gjatë periudhës raportuese.**

<sup>17</sup> COM(2015)0452

Këta tregues të performancës janë prekur negativisht nga një problem i madh i migrimit të parregullt nga fundi i vitit 2014 deri në prill të vitit 2015. Që nga ajo kohë, janë marrë një sërë masash nga autoritetet e Kosovës për të parandaluar një krizë të re të migrimit.

Të dhënat dhe informatat në dispozicion japin trendët e mundshme kryesore në fushat e migrimit dhe të sigurisë, duke treguar se BE-ja mbetet një destinacion tërheqës për emigrantët nga Kosova me sfida të mundshme të migrimit dhe të sigurisë që do të monitorohen.

## 2. STATISTIKAT

Figura 2.1. Aplikimet për viza afatshkurtra Shengen në Prishtinë, Kosovë, 2012-2014

Viti	Kategoria e vizës	Belgjikë/Holandë/ Luksemburgu	Gjermani	Greqi	Finlandë	Hungari	Sloveni	Zvicër/Austri/ Francë/Lihtenshtajn	Norvegji	Gjithsej
2014	Gjithsej aplikimet për vizat e kat. A dhe C	2.967	28.924	6.937	1.360	2.468	3.734	22.531	1.549	70.470
	Gjithsej viza të dhëna të kat. A dhe C	1.943	23.531	5.995	1.181	1.788	2.798	16.709	1.419	55.364
	Gjithsej viza të refuzuara të kat. A dhe C	868	5.393	942	172	641	936	5.822	130	14.904
	<b>Shkalla e refuzimit për vizat e kat. A dhe C</b>	<b>29,3%</b>	<b>18,6%</b>	<b>13,6%</b>	<b>12,6%</b>	<b>26,0%</b>	<b>25,1%</b>	<b>25,8%</b>	<b>8,4%</b>	<b>21,1%</b>
2013	Gjithsej aplikimet për vizat e kat. A dhe C	2.823	26.071	4.556	1.314	2.819	4.415	23.917	1.496	67.411
	Gjithsej viza të dhëna të kat. A dhe C	1.915	21.849	4.275	1.144	2.067	3.281	17.993	1.279	53.803
	Gjithsej viza të refuzuara të kat. A dhe C	869	4.222	281	170	753	1.134	5.924	217	13.570
	<b>Shkalla e refuzimit për vizat e kat. A dhe C</b>	<b>30,8%</b>	<b>16,2%</b>	<b>6,2%</b>	<b>12,9%</b>	<b>26,7%</b>	<b>25,7%</b>	<b>24,8%</b>	<b>14,5%</b>	<b>20,1%</b>
2012	Gjithsej aplikimet për vizat e kat. A dhe C	2.774	25.733	485	1.282	2.289	4.631	22.131	759	60.084
	Gjithsej viza të dhëna të kat. A dhe C	1.829	16.600	441	989	1.618	3.295	17.553	532	42.857
	Gjithsej viza të refuzuara të kat. A dhe C	926	5.404	44	293	671	1.336	4.578	227	13.479
	<b>Shkalla e refuzimit për vizat e kat. A dhe C</b>	<b>33,4%</b>	<b>21,0%</b>	<b>9,1%</b>	<b>22,9%</b>	<b>29,3%</b>	<b>28,8%</b>	<b>20,7%</b>	<b>29,9%</b>	<b>22,4%</b>

Burimi: Zyra e BE-së, Grupi Lokal i Bashkëpunimit të Shteteve Anëtare të Zonës Shengen (Këto shifra nuk kanë mundur të verifikohen nga Komisioni)



**Figura 2.2. Qytetarëve të Kosovës që iu është refuzuar hyrja në kufijtë e jashtëm të zonës Shengen, 2012-2014**

Shtetet Anëtare/Shtetet Anëtare të Zonës Shengen	2012	2013	2014
Belgjikë	35	25	15
Bullgari	65	60	160
Republika Çeke	0	0	0
Danimarkë	0	0	0
Gjermani	85	90	55
Estoni	0	0	0
Irlandë	5	10	5
Greqi	40	15	40
Spanjë	0	0	0
Francë	235	110	65
Kroaci	0	720	560
Itali	30	50	35
Qipro	0	0	0
Latoni	0	0	0
Lituani	0	0	0
Luksemburg	0	0	0
Hungari	80	140	150
Maltë	0	0	0
Holanda	0	0	0
Austri	10	5	5
Poloni	0	0	0
Portugali	0	0	0
Romani	0	0	5
Slloveni	0	150	115
Sllovaki	0	0	0
Finlandë	0	0	0
Suedi	0	0	5
Mbretëria Bashkuar	40	40	55
Islandë	0	0	0
Lihtenshtajni	0	5	0
Norvegji	0	0	0
Zvicër	45	45	45
<b>Gjithsej (BE + SHAZSH)</b>	<b>670</b>	<b>1.465</b>	<b>1.315</b>

*Burimi: Eurostat, llogaritjet e DG HOME*

**Figura 2.3. Qytetarët e Kosovës që janë gjetur duke qëndruar në mënyrë të paligjshme në Shtetet Anëtare të BE-së dhe në Shtetet Anëtare të Zonës Shengen, 2012-2014**

Shtetet Anëtare/ Shtetet Anëtare të Zonës Shengen	2012	2013	2014
Belgjikë	250	290	295
Bullgari	5	5	5
Republika Çeke	15	45	185
Danimarkë	10	0	10
Gjermani	2.645	3.070	4.110
Estoni	0	0	0
Irlandë	25	5	0
Greqi	95	60	35
Spanjë	0	0	0
Francë	610	845	1.270
Kroaci	0	275	230
Itali	180	180	130
Qipro	0	0	0
Letoni	0	0	0
Lituani	0	0	0
Luksemburg	20	25	35
Hungari	190	965	2.075
Maltë	0	0	0
Holandë	0	0	0
Austri	495	1.175	1.780
Poloni	10	10	5
Portugali	0	0	0
Romani	0	0	0
Slloveni	0	100	100
Sllovaki	5	15	75
Finlandë	50	40	40
Suedi	525	725	1.370
Mbretëria Bashkuar	70	100	90
Islandë	0	0	0
Lihtenshtajn	0	0	0
Norvegji	45	65	90
Zvicër	1.280	1.790	1.615
<b>Gjithsej (BE + SHAZSH)</b>	<b>6.525</b>	<b>9.785</b>	<b>13.545</b>

Burimi: Eurostat, llogaritjet e DG HOME

## 2.4. Kërkesat e parashtruara nga qytetarët e Kosovës për azil në Shtetet Anëtare të BE-së dhe Shtetet Anëtare të Zonës Shengen, 2012-2015.

Shtetet Anëtare/ Shtetet Anëtare të Zonës Shengen	2012	2013	2014	2015 3 tremujorët e parë
Belgjikë	1.740	1.270	840	655
Bullgari	0	0	0	0
Republika Çeke	10	10	15	5
Danimarkë	130	80	80	75
Gjermani	2.535	4.425	8.920	34.195
Estoni	0	0	0	0
Irlandë	5	5	5	10
Greqi	0	0	0	0
Spanjë	0	0	0	0
Francë	3.715	5.550	2.770	3.230
Kroaci	0	5	5	0
Itali	100	100	105	180
Qipro	0	0	0	0
Letoni	0	0	0	0
Lituani	0	0	0	0
Luksemburg	210	160	140	180
Hungari	225	6.210	21.455	24.215
Maltë	0	0	0	0
Holandë	40	50	60	495
Austri	310	935	1.905	2.355
Poloni	0	0	0	0
Portugali	0	0	0	5
Romani	0	0	0	0
Slloveni	20	35	20	10
Sllovaki	0	0	0	0
Finlandë	80	70	65	130
Suedi	1.045	1.270	1.480	1.590
Mbretëria e Bashkuar	40	40	30	15
Islandë	0	0	0	0
Lihtenshtajn	0	5	5	5
Norvegji	130	255	145	160
Zvicër	585	700	405	465
<b>Gjithsej (BE + SHAZSH)</b>	<b>10.920</b>	<b>21.175</b>	<b>38.450</b>	<b>67.975</b>

Burimi: Eurostat, llogaritjet e DG HOME

## 2.5. Shkalla e pranimit te azilit në instancën e parë të parashtruar nga qytetarët e Kosovës në Shtetet Anëtare dhe Shtetet Anëtare të Zonës Shengen

Gjithsej vendimet	2012	2013	2014	Vendimet pozitive	2012	2013	2014	Shkalla e njohjes	2012	2013	2014
Belgjikë	1.240	535	550	Belgjikë	95	30	55	Belgjikë	7,7%	5,6%	10,0%
Bullgari	0	0	Bul 0	Bullgari	0	0	B 0	Bullgari	0,0%	0,0%	0,0%
Republika Çeke	10	15	10	Republika Çeke	0	0	0	Republika Çeke	0,0%	0,0%	0,0%
Danimarkë	135	80	100	Danimarkë	10	0	15	Danimarkë	7,4%	0,0%	15,0%
Gjermani	2.655	2.860	2.320	Gjermani	55	35	40	Gjermani	2,1%	1,2%	1,7%
Estoni	0	0	Est 5	Estoni	0	0	E 5	Estoni	0,0%	0,0%	100,0%
Irlandë	5	0	Irla 5	Irlandë	0	0	I 0	Irlandë	0,0%	0,0%	0,0%
Greçi	0	5	Gre 0	Greçi	0	0	C 0	Greçi	0,0%	0,0%	0,0%
Spanjë	0	0	Spa 0	Spanjë	0	0	S 0	Spanjë	0,0%	0,0%	0,0%
Francë	2.500	4.415	5.510	Francë	210	205	530	Francë	8,4%	4,6%	9,6%
Kroaci	0	0	Kr 5	Kroaci	0	0	K 0	Kroaci	0,0%	0,0%	0,0%
Itali	85	110	110	Itali	45	60	55	Itali	52,9%	54,5%	50,0%
Qipro	0	0	Qip 0	Qipro	0	0	Ç 0	Qipro	0,0%	0,0%	0,0%
Letoni	0	0	Let 0	Letoni	0	0	L 0	Letoni	0,0%	0,0%	0,0%
Lituani	0	0	Lit 0	Lituani	0	0	L 0	Lituani	0,0%	0,0%	0,0%
Luksemburg	175	230	100	Luksemburg	0	5	5	Luksemburg	0,0%	2,2%	5,0%
Hungari	45	1.010	3.575	Hungari	5	0	10	Hungari	11,1%	0,0%	0,3%
Maltë	0	0	Ma 0	Maltë	0	0	M 0	Maltë	0,0%	0,0%	0,0%
Holandë	25	45	40	Holandë	0	0	0	Holandë	0,0%	0,0%	0,0%
Austri	265	775	: Aust	Austri	35	30	: Austria	Austri	13,2%	3,9%	0,0%
Poloni	0	0	Pol 0	Poloni	0	0	P 0	Poloni	0,0%	0,0%	0,0%
Portugali	0	0	Por 0	Portugali	0	0	P 0	Portugali	0,0%	0,0%	0,0%
Romani	0	0	Ro 0	Romani	0	0	R 0	Romani	0,0%	0,0%	0,0%
Sllloveni	20	15	Slllo	Sllloveni	0	0	Sllloven	Sllloveni	0,0%	0,0%	0,0%
Slllovaki	0	0	Sll 0	Slllovaki	0	0	S 0	Slllovaki	0,0%	0,0%	0,0%
Finlandë	75	85	105	Finlandë	10	35	45	Finlandë	13,3%	41,2%	42,9%
Suedi	725	1.050	655	Suedi	40	30	65	Suedi	5,5%	2,9%	9,9%
Mbretëria e Bashkuar	15	20	55	Mbretëria e Bashkuar	5	5	5	Mbretëria e Bashkuar	33,3%	25,0%	9,1%
Islandë	0	0	Isla 0	Islandë	0	0	I 0	Islandë	0,0%	0,0%	0,0%
Lihtenshtajn	0	5	Lih 0	Lihtenshtajn	0	0	L 0	Lihtenshtajn	0,0%	0,0%	0,0%
Norvegji	125	220	100	Norvegji	5	10	0	Norvegji	4,0%	4,5%	0,0%
Zvicër	355	435	405	Zvicër	50	85	165	Zvicër	14,1%	19,5%	40,7%
<b>Gjithsej (BE + SHAZSH)</b>	<b>8.455</b>	<b>11.905</b>	<b>13.655</b>	<b>Gjithsej (BE + SHAZSH)</b>	<b>565</b>	<b>530</b>	<b>995</b>	<b>Gjithsej (BE + SHAZSH)</b>	<b>6,7%</b>	<b>4,5%</b>	<b>7,3%</b>

Burimi: Eurostat, llogaritjet e DG Home

## 2.6. Aplikacionet e riparimit të përpunuara nga Kosova

Kategoria/Viti	2013	2014	2015 (jan-tet)
<b>Kërkesa për riparim nga</b>			
SHA + SHAZSH të BE-së	3.778	2.535	10.144
<b>Kërkesat e pranuar nga Kosova</b>	3.095	2.164	9.182
<b>Kërkesat e refuzuara nga Kosova</b>	<b>404</b>	<b>208</b>	<b>188</b>
<b>Kërkesat në pritje</b>	279	163	417
<b>Kthimet efektive në Kosovë</b>	2.279	2.164	9.182

*Burimi: Qeveria e Kosovës (Këto shifra nuk kanë mundur të verifikohen nga Komisioni)*

## 2.7. Shkalla e kthimit të qytetarëve kosovar nga Shtetet Anëtare

Urdhrat për largim	2012	2013	2014	Kthimet efektive	2012	2013	2014	Shkalla e kthimit	2012	2013	2014
Belgjikë	2.345	2.070	1.035	Belgjikë	445	420	250	Belgjikë	19,0%	20,3%	24,2%
Bullgari	5	5	5	Bullgari	5	5	5	Bullgari	100,0%	100,0%	100,0%
Republika Çeke	10	10	30	Republika Çeke	0	5	10	Republika Çeke	0,0%	50,0%	33,3%
Danimarkë	180	100	50	Danimarkë	45	75	70	Danimarkë	25,0%	75,0%	140,0%
Gjermani	1.180	1.275	1.505	Gjermani	855	1.005	1.095	Gjermani	72,5%	78,8%	72,8%
Estoni	0	0	0	Estoni	0	0	0	Estoni			
Irlandë	10	20	5	Irlandë	5	5	0	Irlandë	50,0%	25,0%	0,0%
Greqi	0	0	35	Greqi	0	0	0	Greqi			0,0%
Spanjë	0	0	0	Spanjë	0	0	0	Spanjë			
Francë	2.070	2.205	2.700	Francë	465	390	490	Francë	22,5%	17,7%	18,1%
Kroaci	n/a	285	270	Kroaci	n/a	275	245	Kroaci	n/a	96,5%	90,7%
Itali	180	180	130	Itali	65	50	35	Itali	36,1%	27,8%	26,9%
Qipro	0	0	0	Qipro	0	0	0	Qipro			
Letoni	0	0	0	Letoni	0	0	0	Letoni			
Lituani	0	0	0	Lituani	0	0	0	Lituani			
Luksemburg	260	200	85	Luksemburg	45	100	170	Luksemburg	17,3%	50,0%	200,0%
Hungari	1.610	1.785	1.910	Hungari	1.300	1.44	1.270	Hungari	80,7%	80,7%	66,5%
Maltë	0	0	0	Maltë	0	0	0	Maltë			
Holandë	35	105	125	Holandë	30	45	35	Holandë	85,7%	42,9%	28,0%
Austri	330	720	n/a	Austri	365	790	n/a	Austri	110,6%	109,7%	n/a
Poloni	0	5	5	Poloni	0	5	5	Poloni		100,0%	100,0%
Portugali	0	0	0	Portugali	0	0	0	Portugali			
Romani	0	0	0	Romani	0	0	0	Romani			
Slloveni	0	100	100	Slloveni	0	90	90	Slloveni		90,0%	90,0%
Sllovaki	5	0	20	Sllovaki	5	0	15	Sllovaki	100,0%		75,0%
Finlandë	110	90	n/a	Finlandë	80	80	n/a	Finlandë	72,7%	88,9%	n/a
Suedi	865	665	755	Suedi	795	920	390	Suedi	91,9%	138,3%	51,7%
Mbretëria e Bashkuar	70	100	90	Mbretëria e Bashkuar	85	100	95	Mbretëria Bashkuar	121,4%	100,0%	105,6%
<b>BE-28</b>	<b>9.265</b>	<b>9.915</b>	<b>8.855</b>	<b>BE-28</b>	<b>4.595</b>	<b>5.795</b>	<b>4.265</b>	<b>BE-28</b>	<b>49,6%</b>	<b>58,4%</b>	<b>48,2%</b>

Burimi: Eurostat, llogaritjet e DG Home